



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.1399 prot.

Tiranë më 19.08.2021

RELACION HETIMI ADMINISTRATIV PËR PËRHAPJEN E PALIGJSHME
TË TË DHËNAVE PERSONALE TË SHTETASVE

A. RELACIONI

Ky relacion hetimi administrativ për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale të shtetasve (në vijim, “*Relacioni*”) është përgatitur, në përputhje me nenet 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar (në vijim, “*Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”), si dhe Krerët X dhe XI të Pjesës së Katërt të Kodit të Procedurave Administrative, në kuadër të hetimeve administrative të kryera pranë kontrolluesve si vijon:

- (i) Lapsi.AI SHPK (në vijim, “*Lapsi.al*”), bazuar në urdhrin nr. 45, datë 19.04.2021, me objekt “*Verifikim lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, nisur nga informacionet e publikuara në median elektronike*”;
- (ii) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (në vijim, “*DPGJC*”), bazuar në urdhrin nr. 46, datë 19.04.2021, me objekt “*Verifikim lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, nisur nga informacionet e publikuara në median elektronike*”;
- (iii) Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (në vijim, “*AKSHI*”), bazuar në urdhrin nr. 47, datë 19.04.2021, me objekt “*Verifikim lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, nisur nga informacionet e publikuara në median elektronike*”;
- (iv) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (në vijim, “*DPT*”), bazuar në urdhrin nr. 53, datë 29.04.2021, me objekt “*Verifikim lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, nisur nga informacionet e publikuara në median elektronike*”;

- (v) Partia Socialiste e Shqipërisë (në vijim, “PSSH”), bazuar në urdhrin nr. 57, datë 05.05.2021, me objekt “Verifikim lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, nisur nga informacionet e publikuara në median elektronike, si dhe verifikimi i ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Komisionerit”;
- (vi) Partia Bindja Demokratike (në vijim, “BD”), bazuar në urdhrin 74, datë 28.05.2021, me objekt “Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar”.

Gjithashtu, pas fillimit kryesisht të procesit të hetimit administrativ, pranë Zyrës së Komisionerit janë depozituar ankesat e mëposhtme, të cilat lidhen me objektin e hetimit administrativ:

- a. 2 ankesa për Lapsi.al;
- b. 4 ankesa për DPGJC;
- c. 31 ankesa për AKSHI;
- ç. 1 ankesë për DPT
- d. 40 ankesa për PSSH;
- dh. 1 ankesë për subjektin politik BD; si dhe
- e. 2 ankesa për një kandidat për deputet.

Sa më sipër, ky Relacion përbëhet nga 2 pjesë kryesore:

- *Pjesa 1* - Hetimi administrativ kryesisht, me objekt “Verifikimi lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, nisur nga informacionet e publikuara në median elektronike”; dhe
- *Pjesa 2* - Hetimi administrativ bazuar në ankesë, sipas të dhënave të treguara në germat “a” deri “e” më sipër.

B. Faktet dhe rrethanat e zhvillimit të hetimit

Më datë 11.04.2021, Lapsi.al ka publikuar një lajm me titull “Ekskluzive/ Si na monitoron Rilindja nr e telefonit, nr ID, vendet e punës, të dhënat konfidenciale për 910 mijë votues të Tiranës”, i cili gjendet në lidhjen: <https://lapsi.al/2021/04/11/ekskluzive-si-na-monitoron-rilindja-nr-e-telefonit-nr-id-vendet-e-punes-te-dhenat-konfidenciale-per-910->

[mije-votues-te-tiranes/](#), nëpërmjet të cilit, kontrolluesi në fjalë, bën me dije se ka siguruar një databazë (bazë të dhënash) me të dhënat personale të 910 mijë subjekteve të të dhënave, të Bashkisë Tiranë, nga mosha 19 deri 99 vjeç.

Nisur nga ky publikim, Zyra Komisionerit, me shkresën nr. 674 prot., datë 12.04.2021, ka kërkuar nga Lapsi.al vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit që dispononte në lidhje me rastin në fjalë, por pa asnjë reagim nga ana e kontrolluesit.

Nga ana tjetër, disa ditë më vonë, Zyra e Komisionerit ka ardhur në posedim të një baze të dhënash (data_tirana_2021_Backup_Backup.accdb), në të cilën rezultojnë të përpunuara të dhënat personale të 91 061 (*nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëdhjetë e një*) subjekteve të të dhënave (në vijim, “*Baza e të Dhënave*”). Kjo Bazë të Dhënash rezulton të ketë qarkulluar nëpërmjet kanaleve të ndryshme komunikimi.

Nga të dhënat e elektronike (*properties*) të Bazës së të Dhënave, konstatohet se ajo është krijuar më datë 31.03.2021, ora 20:23:46, me përmasa 369MB. Vlen të theksohet se informacioni për krijimin e Bazës së të Dhënave rezulton nga dokumenti elektronik (*file*) në dispozicion të Zyrës së Komisionerit, çfarë nuk përjashton mundësinë e krijimit të saj më herët.

Baza e të Dhënave përbëhet nga 20 kolona me të dhënat si vijon:

1. Numër rendor (Nr.);
2. Numër identifikimi personal (NID);
3. Emri;
4. Mbiemri;
5. Atësi;
6. Datëlindje;
7. Qendra e votimit¹ (QV);
8. Lista nr.;
9. Telefon (tel);
10. Emigrant;

¹ Kolona në fjalë është titulluar “QV”. Dokumenti nuk përmban një seksion shpjegues akronimesh, por nisur nga informacioni në kolonat e tjera vlerësojmë se bëhet fjalë për “*Qendrën e votimit*”.

11. Vendi emigrimit (*Country emigrant*);
12. I sigurtë;
13. Koment;
14. Patronazhist;
15. Preferenca;
16. Census 2013;
17. Census 2013
18. Vendlindja;
19. Kompania²;
20. Kod banese.

Nga kërkimet e ekspertëve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) të Zyrës së Komisionerit, rezultojnë pamundur të identifikohet, në të dhënat elektronike (*properties*) të Bazës së të Dhënave, krijuesi dhe/ose origjina elektronike e këtij dokumenti.

Më tej, është konstatuar një përhapje masive, e paligjshme, e Bazës së të Dhënave, ndër të tjera, nëpërmjet faqeve të internetit www.patronazhisti.com dhe <https://adfrehasdghf.web.app/>, shkak për të cilin Zyra e Komisionerit, nëpërmjet shkresave me nr. 693 prot., datë 16.04.2021 dhe 693/1prot., datë 19.04.2021, i është drejtuar Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për bllokimin e menjëhershëm të tyre, si dhe fillimin e procedimit ligjor të personave që zotërojnë/posedojnë këto faqe interneti, në të cilat rezultojnë të publikohen të dhënat personale të shtetasve që supozohen të jenë marrë nga Baza e të Dhënave.

Në bazë të pikës 20 të nenit 3 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përhapja e të dhënave nënkupton komunikimin e informacionit për të dhënat personale palëve të papërcaktuara, në çfarëdo forme, edhe përmes vënies në dispozicion ose për konsultime.

Përhapja e të dhënave, si formë e posaçme përpunimi (siç përkufizohet në pikën 12 të nenit 3 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale), duhet të realizohet në përputhje me parimet dhe kriteret e neneve 5 dhe 6 të ligjit në fjalë. Konkretisht, si vijon:

(i) *Parimet e mbrojtjes së të dhënave personale (neni 5):*

² Nisur nga përmbajtja e informacionit në këtë kolonë, rezultojnë se fjala është për punëdhënësin.

- a. Përpunim në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;
- b. Grumbullim për qëllime specifike, të përcaktuara qartë e legjitime, si dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime;
- c. Përpunim bazuar në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mostejkalimin e këtij qëllimi;
- ç. Përpunim bazuar në saktësinë që të dhënat duhet të kenë dhe, kur është e nevojshme, të dhënat duhet të përditësohen; duhet ndërmarrë çdo hap i arsyeshëm për të fshirë apo korigjuar të dhënat e pasakta apo të paplota, në lidhje me qëllimin për të cilin janë mbledhur apo për të cilin përpunohen më tej;
- d. Mbajtjen e të dhënave në atë formë që të lejojë subjektet e të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej;

(ii) *Kriteret ligjore të përpunimit (neni 6):*

- a. Përpunim me pëlqimin e subjektit të të dhënave;
- b. Përpunim për përmbushjen e një kontrate, për të cilën subjekti i të dhënave është palë kontraktuese, apo për diskutime ose ndryshime të një projekti/kontrate me propozimin e subjektit të të dhënave;
- c. Përpunim për të mbrojtur interesat jetike të subjektit të të dhënave;
- ç. Përpunim për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit;
- d. Përpunim për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
- dh. nëse është thelbësor për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të kontrolluesit, marrësit apo personave të tjerë të interesuar. Por, në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale nuk mund të jetë në kundërshtim të hapur me të drejtën e subjektit të të dhënave për mbrojtjen e jetës personale dhe private.

Përveç sa më sipër, meqenëse Baza e të Dhënave përmban shënime/komente lidhur me votën elektorale të subjekteve të të dhënave të përfshira në të, rezulton se kjo bazë të dhënash përmban edhe të dhëna sensitive në kuptim të përkufizimit të sanksionuar në pikën 4 të nenit 3 të Ligjit për Mbrojtjen të Dhënave Personale, në bazë të të cilit e dhënë sensitive është çdo informacion për personin fizik (individin) që ka të bëjë, ndër të tjera, me mendimet politike.

Nisur nga rëndësia e tyre, të dhënat sensitive gëzojnë një mbrojtje të posaçme nga neni 7 i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas të cilit përpunimi i këtyre të dhënave bazohet në kriteret si vijon:

- a. Subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin, që mund të revokohet në çdo çast dhe e bën të paligjshëm përpunimin e mëtejshëm të të dhënave;
- b. Është në interesin jetik të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër dhe subjekti i të dhënave është fizikisht ose mendërisht i paaftë për të dhënë pëlqimin e vet;
- c. Autorizohet nga autoriteti përgjegjës për një interes të rëndësishëm publik, nën masa të përshtatshme mbrojtëse;
- ç. Lidhet me të dhëna, që janë bërë haptazi publike nga subjekti i të dhënave ose është i nevojshëm për ushtrimin apo mbrojtjen e një të drejte ligjore;
- d. Të dhënat përpunohen për qëllime historike, shkencore ose statistikore, nën masa të përshtatshme mbrojtëse;
- dh. Të dhënat kërkohen për qëllime të mjekësisë parandaluese, diagnostikimit mjekësor, sigurimit të kujdesit shëndetësor, kurimit, menaxhimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe përdorimi i tyre kryhet nga personeli mjekësor ose persona të tjerë, që kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë;
- e. Të dhënat përpunohen nga organizatat jofitimprurëse politike, filozofike, fetare ose sindikaliste, për qëllime të veprimtarisë të tyre të ligjshme, vetëm për anëtarët, sponsorizuesit ose personat e tjerë, që kanë lidhje me veprimtarinë e tyre. Këto të dhëna nuk u bëhen të ditura një pale të tretë, pa pëlqimin e subjektit të të dhënave, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj;
- ë. Përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e detyrimit ligjor dhe të të drejtave specifike të kontrolluesit në fushën e punësimit, në përputhje me Kodin e Punës.

Rezulton e qartë se Baza e të Dhënave përmban të dhëna personale të subjekteve të të dhënave, siç përkufizohen në pikën 1 të nenit 3 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas së cilës e dhënë personale është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Sa më sipër, nisur nga shkalla jashtëzakonisht e gjerë e përpunimit të të dhënave në Bazën e të Dhënave, në kundërshtim me parimet dhe kriteret e përpunimit të të dhënave personale, Zyra e Komisionerit vlerëson se përhapja masive e Bazës së të Dhënave përbën cënimin më të rëndë të jetës private dhe të së drejtës së shtetasve për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale, e cila në fjalorin ligjor ndërkombëtar njihet si “*personal data breach*”.

Për këto arsye, bazuar në nenin 30 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Zyra e Komisionerit filloi hetimin administrativ kryesisht, për kontrolluesit e listuar në seksionin “A” të këtij Relacioni.

Vlen të theksohet se hetimi administrativ i Zyrës së Komisionerit është i zbatueshëm për atë sa shkelja përkatëse (në këtë rast, përhapja e paligjshme e të dhënave personale) nuk përbën vepër penale, ndër të tjera, në kuptim të nenit 122 të Kodit Penal.

PJESA 1 - Hetimi administrativ kryesisht

Bazuar në rrethanat dhe faktet e parashtuara në Seksionin “B” të këtij Relacioni, Zyra e Komisionerit filloi hetimin administrativ kryesisht pranë kontrolluesve të treguar në pikat (i) deri (v) të seksionit “A” të tij.

1.1 Lapsi.al

Me shkresën Nr. 674 Prot., datë 12.04.2021, është kërkuar nga kontrolluesi Lapsi.al vënia në dispozicion e informacionit/dokumentacionit që ky subjekt disponon në lidhje me Bazën e të Dhënave.

Pavarësisht kërkesës së Zyrës së Komisionerit, nga kontrolluesi në fjalë nuk ka patur asnjë reagim në lidhje me të.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit ka nisur hetimin administrativ kryesisht ndaj Lapsi.al, në bazë të urdhrin nr. 45, datë 19.04.2021, me objekt “*Verifikim lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, nisur nga informacionet e publikuara në median elektronike*”.

Inspektorët e Zyrës së Komisionerit janë paraqitur 2 herë pranë ambienteve në të cilat Lapsi.al ushtron veprimtarinë e tij, konkretisht më datë 19.04.2021 dhe 21.04.2021, por ka qenë e pamundur kontaktimi me përfaqësuesit e kontrolluesit, pasi zyrat kanë qenë të mbyllura dhe nuk pa patur prezencë personeli.

Inspektorët kanë mbajtur procesverbalin përkatës për secilin prej rasteve, në të cilat janë paraqitur pranë ambienteve të kontrolluesit.

Në vijim, Zyra e Komisionerit është informuar me shkresën nr. 3310 Prot., datë 20.04.2021 (protokolluar me tonën, me nr. prot. 744, datë 21.04.2021), nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), në lidhje me regjistrimin e procedimit penal nr. 95 të vitit 2021, për veprat penale “*Përhapja e sekreteve vetjake*” dhe “*Korrupsion aktiv në zgjedhje*”, parashikuar nga nenet 122 dhe 328 të Kodit Penal.

Sipas shkresës së SPAK, procedimi penal është regjistruar pas publikimeve, nga Lapsi.al, “*i një baze të dhënash në të cilën janë evidentuar të dhëna personale dhe sensitive të qytetarëve shqiptarë*”.

Zyra e Komisionerit konstaton se kontrolluesi Lapsi.al është subjekt i një hetimi procedural penal nga SPAK.

1.2. DPGJC

Në zbatim të Urdhrit nr. 46, datë 19.04.2021, Zyra e Komisionerit ushtroi hetim administrativ pranë kontrolluesit Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (në vijim, "DPGJC"), me objekt "Verifikim lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, nisur nga informacionet e publikuara në median elektronike".

Gjatë hetimit, të zhvilluar më datë 19.04.2021, Zyra e Komisionerit paraqiti pranë DPGJC një listë me pyetje dhe kërkesa në lidhje me veprimtaritë përpunuese të të dhënave personale nga kontrolluesi në fjalë.

Informacioni i kërkuar nga DPGJC u përcoll në rrugë shkresore, me shkresën nr. 1731, datë 29.04.2021 (protokolluar me tonën me nr. prot. 703/3, datë 30.04.2021), me përmbajtjen si vijon:

(i) Në lidhje me kërkesën për të listuar kategoritë e të dhënave personale që përpunon DPGJC, kontrolluesi disponon si vijon:

"DPGJC është institucion varësie i Ministrisë së Brendshme dhe ka për objekt zbatimin e ligjit nr.10 129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile" të ndryshuar dhe ligjin nr.9270, datë 29.7.2004 "Për sistemin e adresave" i ndryshuar. Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen nga kontrolluesi konstatohet të jenë ato të parashikuara në Ligjin nr.10 129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile" të ndryshuar.";

(ii) Në lidhje me kërkesën për të listuar palët e treta tek të cilat përhapen të dhëna personale, si dhe bazën ligjore përkatëse, kontrolluesi disponon si vijon:

"Në lidhje me këtë pikë, ju lutem referojuni udhëzimit nr. 463, datë 10.12.2020, të përbashkët të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrit të Brendshëm "Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin, specifikisht sipas aneksit I, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi "Lista e institucioneve që marrin informacion, baza ligjore përkatëse, lloji dhe sasia e informacionit që jep shërbimi i gjendjes civile dhe mënyra e vënies në dispozicion të këtij informacioni".

Gjithashtu, pjesë e listës së palëve të treta që aksesojnë të dhëna nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC) i vitit 2010, nëpërmjet shërbimeve web (web-service) janë:

- *Shoqëria Koncesionare ALEAT, që ofron shërbimin e prodhimit të letërnjoftimeve elektronike dhe pasaportave biometrike, sipas Kontratës koncesionare, "Për prodhimin dhe shpërndarjen e letërnjoftimeve elektronike dhe të pasaportave biometrike", ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së*

Shqipërisë dhe grupimit SAGEM Securite (aktualisht Safran Identity and Security) dhe Fondin Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, e ratifikuar me ligjin nr.9972, datë 28.07.2008, i ndryshuar, me ligjin nr.10322, datë 23.09.2010 dhe ligjin nr.129/2013, datë 25.04.2013.

- *Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, sipas ligjit nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 294, datë 08.09.2020 të Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 265, datë 25.05.2015 “Mbi bashkëpunimin ndërmjet strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Shërbimit Informativ të Shtetit për procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj me qëndrim të rregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilin po e vëmë në dispozicion.”;*

(iii) Në lidhje me pyetjen “Në kuadër të fushatës zgjedhore, çfarë të dhënash përhapen tek partitë politike, subjektet zgjedhore, KQZ, ku dhe si” si dhe për kërkesën për vënien në dispozicion të ekstraktit të të dhënave që DPGJC vë në dispozicion të KQZ dhe partive politike, kontrolluesi disponon si vijon:

“Në zbatim të Kodit Zgjedhor, nenit 4, parashikohet se: “1. Zgjedhësi identifikohet në RKGJC nga përbërësit zgjedhorë. Përbërës zgjedhorë quhen përbërësit e gjendjes civile si më poshtë:

a) emri;

b) atësia;

c) amësia;

ç) mbiemri;

d) datëlindja;

dh) numri personal i identifikimit;

e) shtetësia;

ë) kodi i vendbanimit;

f) gjinia.

Në këtë kuadër, DPGJC ndan me KQZ-në, përbërësit zgjedhorë të shtetasve, siç parashikohet dhe në udhëzimin e përbashkët të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrit të Brendshëm.

Në nenin 60 të Kodit Zgjedhor, parashikohet vënia e listave të zgjedhësve dhe ekstraktit të përbërësve zgjedhorë në dispozicion të subjekteve zgjedhore dhe publikut, sipas përcaktimeve të pikave:

- 1. Listat e zgjedhësve dhe ekstraktet e përbërësve zgjedhorë vihen në dispozicion të subjekteve zgjedhore ose, sipas rastit, partive politike, me kërkesën e tyre dhe pa pagesë, nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe/ose Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.*
- 2. Subjektet zgjedhore të regjistruara në KQZ ose partitë politike, me kërkesën e tyre dhe pa pagesë, mund të marrin nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile një kopje elektronike të listave të zgjedhësve ose ekstraktit të përbërësve zgjedhorë në shkallë vendi, si dhe sa here që ato përditësohen dhe publikohen, sipas nenit 51 të këtij Kodi. Kopja elektronike hartohet në mënyrë të tillë që të lejojë kërkime dhe krahasime të kryqëzuara të të dhënave.*

Theksojmë se këtu kjo dispozitë parashikon gjithashtu vënien në dispozicion të të dhënave në format elektronik, të atillë që të mundësohet kërkimi, kryqëzimi dhe krahasimi i tyre. DPGJC ka vënë në dispozicion të subjekteve politike listën e zgjedhësve/ekstraktet zgjedhore në format PDF.

Bashkëlidhur këtij informacioni, po ju vëmë në dispozicion një kërkesë të subjektit politik, si dokument orientues të komunikimeve të mbajtura midis DPGJC-së dhe subjekteve politike, si dhe një kopje sample të informacionit të vënë nga ana jonë.”;

(iv) Në lidhje me marrëdhënien me AKSHI-n (kontrollues-përpunues), kontrolluesi disponon si vijon:

“Ministria e Brendshme/DPGJC bashkëpunon me AKSHI-n duke mundësuar akses sipas kërkesës së Institucioneve të përfshira Aneksit I, të Udhëzimit të Përbashkët nr. 476, datë 16.12.2020. Aksesit ofrohet nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit, e cila shërben si porta kryesore e komunikimit midis të dhënave të gjendjes civile dhe palëve të treta të interesuara, sipas fushave të përcaktuara në Aneksin I, të udhëzimit të përbashkët të KDIMDP-së dhe MB-së.

Me miratimin e Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” i ndryshuar, Sistemet e Gjendjes Civile (Sistemi RKGJC dhe Sistemi i Adresave) kanë kaluar nën administrimin të AKSHI-t.

Sipas përcaktimeve në këtë vendim, është detyrë e AKSHI-t të mirëmbajë sistemet e gjendjes civile, të lidhë kontrata për shërbime teknike mirëmbajtje dhe të zhvillojë sistemet që ka nën administrim, duke përcaktuar si institucion përfitues MB/DPGJC.

Në ligjin nr.10129, datë 11.05.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, neni 33, pika 2, parashikohet shprehimisht se: “Regjistri Kombëtar administrohet nga

institucioni përgjegjës, i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave”. Gjithashtu, me ristrukturimin e MB-së, stafi i punës prej 6 punonjësish teknik IT kanë kaluar në varësinë administrative të AKSHI-t.

Bashkëlidhur këtij dokumenti do të gjeni urdhrin nr. 16, datë 13.01.2021, “Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Ministrisë së Brendshme”, si dhe Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit, lidhur midis MB dhe AKSHI.”;

(v) Në lidhje me formën ligjore të rregullimit të marrëdhënies me çdo institucion publik dhe/ose privat tek i cili përhapen të dhënat, kontrolluesi disponon si vijon:

“Për sa i përket kësaj pike, lutemi t’i referoheni udhëzimit të përbashkët midis KDIMDP-së dhe MB-së, si dhe bazës ligjore të përcaktuar qartësisht për çdo institucion, që gëzon të drejtën për të kërkuar të dhëna të administruara nga shërbimi i gjendjes civile, sipas fushave të specifikuara.

Gjithashtu, pjesë e listës së palëve të treta që aksesojnë të dhëna nga RKGJC, nëpërmjet shërbimeve web (web-service) janë:

- *Kompania Koncensionare ALEAT (që ofron shërbimin e prodhimit të letërnjoftimeve elektronike dhe pasaportave biometrike), sipas Kontratës koncesionare, “Për prodhimin dhe shpërndarjen e letërnjoftimeve elektronike dhe të pasaportave biometrike”, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë grupimit SAGEM Securite (aktualisht me emrin Safran Identity and Security) dhe Fondin Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, e ratifikuar me ligjin nr. 9972, datë 28.07.2008, i ndryshuar me ligjin nr.10322, datë 23.09.2010 dhe ligjin nr.129/2013, datë 25.04.2013.*
- *Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, sipas ligjit nr. 108/2014 “Për policinë e Shtetit”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 294, datë 08.09.2020, midis Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ të Shtetit. Sipas udhëzimit nr. 294, datë 08.09.2020 të Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 265, datë 25.05.2015 “Mbi bashkëpunimin ndërmjet strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Shërbimit Informativ të Shtetit për procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj me qëndrim të rregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë”, parashikohet që të dhënat që ruhen në regjistrin elektronik për të huajt, të menaxhuar nga DPPSH, importohen automatikisht në bazën e të dhënave të RKGJC-së.”.*

(vi) Në lidhje me:

- **Masat e sigurisë fizike dhe teknike të sistemeve të vetëadministruara;**
 - **Rolet dhe numri i punonjësve që kanë akses në bazat e të dhënave;**
 - **Loget, gjurmueshmëria e logeve për akseset në sistem;**
- kontrolluesi disponon si vijon:**

Sistemi i gjendjes është i lokalizuar në ambientet e dhomës së serverave, i cili plotëson standardet bashkëkohore të kushteve të sigurisë fizike: me derë të blinduar, me hyrje me akses të kontrolluar, ambient i monitoruar me kamera sigurie, sisteme anti zjarr, etj.

Në kuadër të aspektit teknik, ky sistem ka të implementuar format e aksesit me llogari përdoruesi dhe fjalëkalim, për çdo punonjës të DPGJC-së dhe ZGJC-ve në bashki / njësi administrative ku ofrohet shërbimi i gjendjes civile.

Ky sistem ka të implementuar 2 nivele aksesit në të dhënat e tij, konkretisht, akses për kërkim dhe akses për përditësim të të dhënave të shtetasve shqiptarë. Veprimet që kryhen në sistemin e Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010, ruhen në bazën e të dhënave të këtij sistemi, duke mundësuar dhe gjurmuar veprimet sipas përdoruesve dhe kohën kur janë kryer.

Aktualisht numërohen 590 përdorues aktiv, që aksesojnë ndërfaqen grafike të përdoruesit (GUI) të sistemit të gjendjes civile nëpërmjet llogarisë dhe fjalëkalimit përkatës.

Përdorues të këtij sistemi janë:

- Punonjësit e Zyrave të Gjendjes Civile me të drejta përditësimi informacioni;

- Konsujt apo punonjësit e atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, me të drejta përditësimi/saktësimi të vendlindjes sipas toponimeve, kërkimi/verifikimi, me qëllim ofrimin e ndihmës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, apo ofrimin e shërbimit të aplikimeve për pasaporta biometrike dhe letërnjoftimeve elektronike;

- Punonjësit e DPGJC-së, me të drejta kërkimi, me qëllim monitorimin cilësisë së shërbimit që ofrohet nga zyrat e gjendjes civile. Kjo kategori përdoruesish nuk kanë të drejtë përditësimi informacioni.

Përdoruesit në nivel baze të dhënash, me të drejta leximi/përditësimi, për të mundësuar administrimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave, si dhe garantimin e kopjeve backup të bazës së të dhënave, duke i ruajtur në pajisjet e dedikuara të backup-it.

Sistemi i gjendjes civile është i përberë nga 2 site reale. Site-i primar është i lokalizuar në ambientet e dhomës së server-ave të gjendjes civile, në Ministrinë e Brendshme. Për të garantuar vazhdueshmërinë operacionale të sistemit, site-i primar është konfiguruar sipas infrastrukturës “cluster”, që mundëson, ndarjen virtuale të këtij site-i, në 2 nën site të pavarur nga ana funksionale dhe që komunikojnë në kohë reale ndërmjet tyre, identike, qoftë nga konfigurimi hardware, ashtu dhe software.

Për të plotësuar më tej këtë tipar dhe aspekt të sigurisë së këtij sistemi, në vitin 2015 është ngritur ambienti dytësor – site sekondar, Qendra e Vazhdueshmërisë së Punës (QVP), në data-center-in që funksionon pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si një implementim shumë i rëndësishëm që garanton sigurimin/mbrojtjen e të dhënave të gjendjes civile, të shtetasve shqiptarë, infrastrukturë e ngritur në bazë të specifikimeve teknike, të miratuara paraprakisht nga AKSHI, institucioni përgjegjës i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për administrimin e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010.

Të 2 site-t, si primari dhe sekondari komunikojnë me njëri-tjetrin dhe ruajtja e të dhënave bëhet identike në të 2 site-t në kohë reale. Infrastruktura e ngritur garanton disponueshmëri të lartë të sistemit të RKGJC-së, duke siguruar vazhdueshmërinë e shërbimeve që ky sistem ofron.

Në funksion të implementimeve të mësipërme, është përmirësuar gjithashtu infrastruktura e rrjetit nëpërmjet krijimit të arkitekturës mbështetëse për komunikim ndërmjet ambientit primar, QVP-së dhe të gjithë palëve të tjera.

Me miratimin paraprak të specifikimeve teknike dhe termave të referencës nga AKSHI, në vitin 2016 u ngrit infrastruktura lokale IT (dhoma e serverave), duke bërë të mundur krijimin e kushteve bashkëkohore të operimit të pajisjeve hardware të sistemeve të gjendjes civile, ku përfshihen punimet për:

- ngritjen e dyshemesë (dysHEMEJA teknologjike);*
- sistemin e kondicionimit sipas standardeve;*
- furnizimin dhe instalimin e sistemit të kondicionimit në përputhje me fuqinë e instaluar dhe nxehtësinë e çliruar në ambient;*
- sistemin e monitorimit dhe të alarmit për detektimin e lagështirës, ndryshimit të temperaturës dhe zjarrit;*
- zgjidhjen për shuarjen e zjarrit, nëpërmjet instalimit të dy automateve në panel “Bypass” për çdo UPS, skermimin e ambientit, sistemin e kamerave, sistemin e kontrollit të aksesit dhe derës sipas standardeve.*

Gjithashtu, nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit, platforme që menaxhohet nga AKSHI, është mundur shkëmbimi i të dhënave me palët e treta, me qëllim shmangien e përhapjes së paligjshme të të dhënave personale.

Sqarojmë se Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC) i vitit 2010 është i aksesueshëm nga një rrjet i mbyllur (LAN) për gjithë përdoruesit, duke shmangur kështu aksesin nga jashtë të të dhënave të këtij sistemi.

Në zbatim të vendimit nr.673, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, të ndryshuar, lidhur me masat e sigurisë fizike dhe teknike, në vazhdim është përgjegjësi e AKSHI-t;

- (vii) Në lidhje me kërkesën për të dhënë sqarime për kontratat dhe raportet me mirëmbajtësit e sistemeve, kontrolluesi disponon si vijon:**

“Kontratat dhe raportet e mbajtura lidhur me mirëmbajtjen e sistemeve të gjendjes civile, administrohen nga AKSHI, si autoriteti kontraktues, me DPGJC-në si autoritet përfitues.”;

- (viii) Në lidhje me kërkesën për të dhëna sqarime lidhur me raportet e auditimeve (të brendshme dhe/ose të jashtëm), kontrolluesi disponon si vijon:**

“Sistemet e gjendjes civile janë audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën e viteve 2017 - 2018, sa i përket aspektit teknik, sipas raportit, kopje të të cilit po e vëmë bashkëlidhur në dispozicion, si dhe raportin mbi auditimin e ekstraktit të 5-të të përbërësve zgjedhorë.”;

- (ix) Në lidhje me pyetjen për mënyrat e aksesimit nga çdo palë e interesuar, kontrolluesi disponon si vijon:**

Të dhënat e shërbimit të gjendjes civile aksesohen nga palët e treta, nëpërmjet shërbimeve web (web-service), si më poshtë:

- RKGJC (DPGJC) > Platforma Qeveritare e Ndërveprimit (AKSHI);

- RKGJC (DPGJC) <> Sistemi i Prodhimit të Letërnjoftimeve Elektronike dhe Pasaportave Biometrike (ALEAT) ;

- RKGJC (DPGJC) <> Sistemi TIMS (Total Information Management System) dhe FER (Foreign Electronic Register) (DPPSH).

Komunikimi midis Platformës Qeveritare të Ndërveprimit, Sistemit të Prodhimit të Letërnjoftimeve Elektronike dhe Pasaportave Biometrike dhe Sistemit TIMS dhe FER, realizohet nëpërmjet lidhjes së dedikuar Dark Fiber, si dhe duke aplikuar standarde sigurie shtesë në konfigurimin e kësaj lidhje:

– Komunikimi midis infrastrukturave të ngritura midis ALEAT dhe DPGJC nëpërmjet llogarive të dedikuara VPN;

– Implementimi i rregullave strikte të aksesit në Firewall të Sistemit të Gjendjes Civile për komunikimet me ALEAT;

– Integrimi i certifikatave të sigurisë, për identifikim të site-ve (DPGJC - ALEAT) me të drejta aksesit dhe klientëve që aksesojnë këtë lidhje; – Aplikimi i autentifikimit midis lidhjeve dy kahesh (DPGJC - ALEAT);

– Komunikimi midis infrastrukturave të ngritura midis DPPSH dhe DPGJC, nëpërmjet llogarive të dedikuara VPN;

– Implementimi i rregullave strikte të aksesit në Firewall dhe Sistemit të Gjendjes Civile për komunikimet me DPPSH-në;

– Integrimi i certifikatave të sigurisë, për identifikim të site-ve (DPGJC - DPPSH) me të drejta aksesit dhe klientëve që aksesojnë këtë lidhje;

– Aplikimi i autentifikimit midis lidhjeve dy kahesh (DPGJC - DPPSH);

– Integrimi i certifikatave të sigurisë, për identifikim të site-ve (DPGJC - AKSHI) me të drejta aksesit dhe klientëve që aksesojnë këtë lidhje;

Legjenda:

> identifikon kalimin e të dhënave në një kah të vetëm;

<> identifikon kalimin e të dhënave në dy kahe (DPGJC jep të dhëna dhe njëkohësisht merr të dhëna, duke i importuar ato në bazën e të dhënave të RKGJCsë);

Në mbështetje të këtij inspektimi, kërkojmë të sqarojmë se ekstraktet e përbërësve zgjedhorë, në përbërje të të cilit janë të gjithë shtetasit me të drejtë vote, të lindur që nga data 25.04.2003, të cilët deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve, më 25.04.2021, do të mbushin 18 vjeç.

Për zgjedhjet e datës 25 prill 2021 për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e Kodit Zgjedhor, janë printuar dhe publikuar në mënyrë periodike në datat 05.11.2020, 05.12.2020, 04.01.2021, 03.02.2021 dhe 05.03.2021, të cilat publikohen në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Brendshme, si dhe publikohen në hapësirat e dedikuara publike në bashki/njësi administrative, sipas qendrave të votimit nën juridiksionin e tyre.

Kjo veprimtari rregullohet në bazë të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 298, datë 10.09.2020 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë”, kopje të të cilit po e vëmë në dispozicion bashkëlidhur, gjithashtu kërkojmë të theksojmë, elementët, përbërësit e gjendjes civile që bëhen publikë nëpërmjet afishimit të listave sipas formatit të listës janë: emër, mbiemër, atësi, datëlindje, konkretizuar sipas shembullit bashkëlidhur.

Konstatim:

Nga krahasimi i të dhënave që DPGJC vë në dispozicion të subjekteve zgjedhore, bazuar në nenin 60 të Kodit Zgjedhor, me ato të Bazës së të Dhënave, rezulton se të dhënat personale (përbërësit zgjedhorë) që DPGJC transmeton tek subjektet në fjalë përkojnë me 6 kategori të dhënash të Bazës së të Dhënave (nga 20 të tilla). Konkretisht, emri, atësia, mbiemri, datëlindja, numri personal dhe shtetësia.

Rrjedhimisht, Zyra e Komisionerit, konstaton se 30% e Bazës së të Dhënave përbëhet nga të dhëna që origjinarisht DPGJC iu transmeton subjekteve zgjedhore në bazë të nenit 60 të Kodit Zgjedhor.

Nga ana tjetër, rezulton se të njëjtët përbërës zgjedhorë iu vihen në dispozicion partive politike edhe nga kryetarët e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Gjithashtu, nga përgjigjet e DPGJC, rezulton se akses në të dhënat që përpunon DPGJC, përfshirë këtu përbërësit zgjedhorë të sipërpërmendur, mund të aksesohen nga shoqëria koncesionare ALEAT, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dhe AKSHI.

Më tej, referuar Udhëzimit nr. 463, datë 10.12.2020, të përbashkët të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrit të Brendshëm *“Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin, specifikisht sipas aneksit I, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi “Lista e institucioneve që marrin informacion, baza ligjore përkatëse, lloji dhe sasia e informacionit që jep shërbimi i gjendjes civile dhe mënyra e vënies në dispozicion të këtij informacioni”*(në vijim, *“Udhëzimi nr. 463”*), rezulton se janë 36 kontrollues të tjerë, të cilët në mbështetje të këtij udhëzimi kanë akses, sipas të drejtave të paracaktuara në kuadër të detyrimeve ligjore përkatëse.

Ndërkohë, referuar regjistrin të shërbimeve të bazave të të dhënave ofrues-konsumues, të administruar nga AKSHI, rezulton se janë 47 institucione publike/private të cilët përfitojnë shërbim (kanë akses) në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile si dhe Operatori Ekonomik kontraktuar nga AKSHI për mirëmbajtjen e RKGJC.

Bazuar në pikën 7 të vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave *“Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”* i ndryshuar (në vijim, *“VKM nr. 673”*), AKSHI është përgjegjës për ekspozimin e *web service*-ve të bazave të të dhënave me qëllim aksesimin e të dhënave parësore për subjektet e interesuara për ndërveprimin në platformën qeveritare të ndërveprimit.

Nga ana tjetër, më datë 09.04.2021, përpara publikimit mediatic të çështjes objekt hetimi, Zyra e Komisionerit i është drejtuar me shkresë, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), DPGJC dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për bllokimin si dhe fillimin e procedimit ligjor për personat/subjektet që qëndrojnë pas faqes së internetit <https://gjendjacivile.blogspot.com/p/falas.html>, si dhe lidhjeve (links) të

aksesueshme përmes kësaj faqeje interneti, pasi në të rezultonte të vijonte publikimi i të dhënave personale të marra nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, i përditësuar deri në vitin 2008.

Vlen të theksohet se kjo problematikë është konstatuar edhe më herët, siç rezulton nga hetimi administrativ i filluar kryesisht nga Zyra e Komisionerit ndaj kontrolluesit DPGJC, në vitin 2019.

Në përfundim të hetimit, Zyra e Komisionerit ka dalë me Rekomandimin nr. 26, datë 05.04.2019, ku, ndër të tjera, ka lënë një sërë detyrash për zbatim nga ana e DPGJC, si dhe i është drejtuar Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me shkresën nr. 198/2 prot, datë 07.02.2019, për marrjen e masave për bllokimin e faqes së internetit, të treguar më sipër.

Rrjedhimisht, për një pjesë të shtetasve, të dhënat e të cilëve janë të përpunuara në Bazën e të Dhënave, rezultojnë të aksesueshme në mënyrë të paligjshme edhe në faqen e mësipërme të internetit.

Bazuar në veprimet procedurale të ndërmarra sipas Urdhrit nr. 46, datë 19.04.2021, të Komisionerit për kryerjen e hetimit administrativ pranë DPGJC, të cilat përshijnë, të tilla si, konstatimet në vend dhe shqyrtimi i bazës ligjore dhe akteve të brendshme të kontrolluesit në fjalë, si dhe referuar nivelit të ulët të përputhshmërisë së kategorive të të dhënave personale që përpunon ky kontrollues, me ato të përpunuara në Bazën e të Dhënave, numrit të papërcaktueshëm të marrësve të të dhënave personale të DPGJC (sidomos në rastin e përbërësve zgjedhorë, të cilët përpunohen (kupto: shpërndahen) më tej nga subjektet zgjedhore), si dhe qarkullimit masiv të Bazës së të Dhënave, si dhe publikimeve të paligjshme në faqen e internetit <https://gjendjacivile.blogspot.com/p/falas.html>, rezulton e pamundur të provohet nëse Baza e të Dhënave është populluar me të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, si rezultat i veprimeve të paligjshme të DPGJC.

Nga ana tjetër, Zyra e Komisionerit konstaton një sërë elementësh që përbëjnë shkelje të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga ky kontrollues.

Së pari, në lidhje me institucionet të cilëve ju është ofruar shërbimi (akses) në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, në raport me institucionet e parashikuara për të patur akses/shërbim në këtë regjistër, sipas Udhëzimit nr. 463. Siç parashtrohet më sipër, rezulton se janë 47 institucione publike/private të cilët kanë akses në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, DPGJC është kontrollues i të dhënave personale që përpunon për përmbushjen e qëllimit dhe detyrave të saj institucionale.

Për këtë arsye, bazuar në nenet 27 dhe 28 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, DPGJC bart detyrimin kryesor për marrjen e masave tekniko-organizative për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale.

Nga përgjigjet e DPGJC, rezulton se, për kontrolluesin në fjalë, aspektet e sigurisë së të dhënave dhe marrëdhënieve me përpunues/bashkëkontrollues të tjerë (përfshirë mirëmbajtës) mbulohen nga AKSHI.

Zyra e Komisionerit vlerëson se angazhimi i përpunuesve/bashkëkontrolluesve (të përcaktuar me akt nënligjor) nuk çliron kontrolluesin nga përgjegjësitë për të mbikëqyrur dhe monitoruar aspektet e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave që kontrolluesi është i autorizuar (me ligj) të përpunojë dhe administrojë.

Bazuar në dispozitat e udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara na subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*), kontrolluesit janë përgjegjës për krijimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, qoftë kur përpunojnë të dhënat me kapacitetet e tyre teknike dhe njerëzore, qoftë kur për ruajtjen e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave angazhohen subjekte të tjera, rast në të cilin kontrolluesi është i detyruar të veprojë edhe në përputhje me dispozitat e nenit 20 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe udhëzimin nr. 19, datë 03.08.2012, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale *“Për rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”* i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 19”*).

1.3 DPT

Në zbatim të Urdhrit nr. 53, datë 19.04.2021, Zyra e Komisionerit ushtroi hetim administrativ pranë DPT, me objekt *“Verifikim lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, nisur nga informacionet e publikuara në median elektronike”*.

Detyrat dhe funksionet e administratës tatimore, të kryesuar nga DPT, përfshijnë, ndër të tjera, mbledhjen e të ardhurave tatimore, si dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, mbajtjen e Regjistrit Qendror të Llogarive Bankare, etj.

Në zbatim të objektit të urdhrit, grupi i kontrollit të Zyrës së Komisionerit, ka kërkuar informacione dhe sqarime në lidhje me proceset përpunuese, kategoritë e të dhënave, kategoritë e subjekteve të të dhënave, marrëdhëniet me palët e treta, aksesin në të dhënat e përpunuara nga DPT, etj.

Informacioni i kërkuar u përcoll në rrugë elektronike, nëpërmjet e-mailit datë 10.05.2021, me përmbajtjen si vijon:

- (i) **Në lidhje me kërkesën për të listuar kategoritë e të dhënave personale që përpunon DPT (në cilësinë kontrolluesit) dhe bazën ligjore për përpunimin e tyre, kontrolluesi disponon si vijon:**

“Siç është shpjeguar edhe në takimet/raportimet e kaluara, DPT nuk ka rol kontrollues të të dhënave të cilat kontrollohen vetëm nga institucionet respektive të cilat i administrojnë ato.”;

- (ii) **Në lidhje me kërkesën për të paraqitur listën e të gjithë databazave, kontrolluesi disponon si vijon:**

“Me shkresën Nr. 2728/1 Prot., datë 20.04.2021 (AKSHI), është dërguar lista e bazave të të dhënave shtetërore të regjistruara pranë AKSHI-it në cilësinë e ARK-së.”;

- (iii) **Në lidhje pyetjen për të dhënë informacion për formën ligjore të rregullimit të marrëdhënies me çdo institucion (kontrata, baza ligjore), kontrolluesi disponon si vijon:**

“Me shkresën Nr. 2728/1 Prot., datë 20.04.2021 (AKSHI), është dërguar lista e bazave të dhënave shtetërore, për të cilat janë cilësuar edhe bazat ligjore respektive të hartuara nga institucionet administruese të tyre. Format ligjore gjenden pranë institucioneve respektive (marrëdhënieve ndërmjet palëve (SLA)).”;

- (iv) **Në lidhje me kërkesën për të venë në dispozicion kontratat me mirëmbajtësit e sistemeve, kontrolluesi disponon si vijon:**

“Kontratat me operatorët që kryejnë mirëmbajtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit duhet të kërkohen rast pas rasti sipas objektit të hetimit.”;

- (v) **Në lidhje me kërkesën për loget (logs) dhe gjurmueshmërinë e logeve (logs) për akseset në sisteme, kontrolluesi disponon si vijon:**

“Loget, gjurmueshmeria e logeve për akseset në sisteme duhet të kërkohen rast pas rasti sipas objektit të hetimit dhe do të vihen në dispozicion në rast se nuk janë informacion i klasifikuar “sekret shtetëror”, i cili vihet në dispozicion vetëm pas plotësimit të të gjithë kriterëve të legjislacionit në fuqi.”;

- (vi) **Në lidhje me kërkesën për të paraqitur informacion për rolet dhe numrin e punonjësve që kanë akses në bazat e të dhënave, kontrolluesi disponon si vijon:**

“Çdo sistem i cili është pjesë e DB-shtetërore ka të mirëdefinuara rolet dhe përgjegjësitë e përdoruesve ku prej të cilave dalin të drejtat dhe detyrimet e çdo

përdoruesi (për etax është urdhër i brendshëm i DP të DPT, formulari i përdoruesit)”;

(vii) Në lidhje me kërkesën për të paraqitur informacion për mënyrat e aksesimit nga çdo palë e interesuar, kontrolluesi disponon:

“Realizohet sipas kushteve të marrëveshjes/SLA mes palëve, ku mund të jetë web service ose me user me të drejta të mirëpëcaktuara nëpërmjet GG.”.

Konstatim:

Hetimi administrativ pranë DPT është realizuar bazuar vetëm në përgjigjet e paraqitura më sipër nga ky kontrollues.

Përgjigjet e paraqitura nga kontrolluesi në fjalë rezultojnë – në pjesën më të madhe të tyre – replikime të përgjigjeve të AKSHI-t, si dhe të bazuara në referenca konkrete të shkresave të përcjella nga AKSHI për Zyrën e Komisionerit, në kuadër të hetimit administrativ të ushtruar pranë këtij të fundit.

Cilësisht, qasja dhe përgjigjet e DPT demonstrojnë mungesë bashkëpunimi, si dhe një mungesë të theksuar të njohurive lidhur me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe, veçanërisht, detyrimeve që ky legjislacion parashikon për kontrollues që përpunojnë të dhëna personale në shkallë të gjerë, siç është DPT.

Mohimi i rolit të kontrolluesit (përgjigja në pikën (i) më sipër) nga ana e DPT, konfirmon konstatimin e mësipërm lidhur me këtë kontrollues.

Në këtë kontekst, vlen të theksohet se detyrat, kompetencat dhe funksionet e DPT janë të parashikuara në një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore, të cilat përcaktojnë pa ekuivok cilësinë e DPT si kontrollues të dhënash. Këto instrumente, përfshijnë, ndër të tjera, ligjet si vijon:

- ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat”* i ndryshuar;
- ligjin nr. 92/2014 *“Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”*;
- ligjin nr. 4/2020 *“Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”*;
- ligjin nr. 154/2020 *“Për regjistrin qendror të llogarive bankare”*;
- ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 *“Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar;

- ligjin nr.10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre, etj.

Sa më sipër, përgjigjet e DPT në lidhje me cilësinë e saj si kontrollues i të dhënave që përpunon, si dhe në lidhje me aksesin në të dhëna, rezultojnë, respektivisht, të pasakta dhe të paplota dhe, rrjedhimisht, pa rëndësi për procesin e hetimit administrativ lidhur me përfshirjen e mundshme të këtij institucioni në popullimin e Bazës së të Dhënave objekt hetimi.

Kjo qasje jobashkëpunuese, shoqëruar me mosadresimin e kërkesave të parashtruara në pikat (ii), (iv) dhe (v) të planit të hetimit – në kundërshtim me nenet 30, 32 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe nenin 77 të Kodit të Procedurave Administrative, nuk mundëson përmbushjen e objektit të hetimit, sipas planit të hetimit.

Nga ana tjetër, duhet të sqarohen shkurtimisht konceptet kryesore të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Në bazë nenit 3 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “*Kontrollues*” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj (pika 5).

Ndërsa, “*Përpunues*” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që përpunon të dhëna personale në emër të kontrolluesit (pika 7).

Në dritën e këtyre përkufizimeve, cilësia e kontrolluesit bartet nga personi i cili përmbush kushtet kumulative si vijon:

- a. Përcakton (vetëm apo së bashku me të tjerë), qëllimet dhe mënyrat e përpunimit; dhe
- b. Përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale (parimi i përgjegjësisë, i parashikuar në pikën 2 të nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale).

Bazuar në dispozitat e instrumenteve ligjore dhe nënligjore të listuara më sipër, DPT rezulton se përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale duke përmbushur, kështu, kushtet e pikës “a” më sipër. Rrjedhimisht, DPT është e detyruar të përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale (germa “b” më sipër).

Bazuar në nenet 27 dhe 28 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në cilësinë e kontrolluesit, DPT ka detyrimin të garantojë sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, të cilat ky kontrollues përpunon.

Edhe pse, bazuar në vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” (në vijim, “VKM nr. 673”), AKSHI (në cilësinë e bashkëkontrolluesit) bart detyrimin për të garantuar sigurinë dhe pacenueshmërinë e sistemeve të infrastrukturave kritike të përdorura nga institucionet shtetërore, si në rastin e DPT, dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me aspektet e sigurisë së të dhënave nuk përjashtojnë nga përgjegjësia ligjore institucionet në fjalë, të cilat kanë detyrimin të demonstrojnë përgjegjshmëri, si dhe mbajnë përgjegjësi, për realizimin e proceseve përpunuese në përputhje me dispozitat e nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Institucionet e administratës shtetërore, si DPT, nuk mund të justifikojnë anomalitë dhe cenimet eventuale në sigurinë e të dhënave, me faktin se për këtë qëllim është përgjegjës AKSHI, bazuar në dispozitat e VKM nr. 673.

Në këtë kontekst, theksojmë se në inspektimet e fundit zhvilluar pranë DPT, në bazë të urdhrit nr. 172 prot., datë 16.11.2020, i cili është pjesë e raportit që i është paraqitur Kuvendit, më datë 08.02.2021, në lidhje me çështjen e sigurisë së të dhënave, Zyra e Komisionerit ka konstatuar si vijon:

“DPT ka hartuar një seri aktesh rregullatore, ku përfshihen parashikime mbi ruajtjen e konfidencialitetit.

Megjithatë, nuk janë konstatuar norma specifike që rregullojnë ruajtjen, mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale gjatë proceseve përpunuese që zhvillon institucioni në përmbushjen e detyrave funksionale.

DPT ka miratuar një rregullore për sigurinë e informacionit në DPT, në të cilën janë specifikuar rregullat e përgjithshme për sigurinë e informacionit dhe përgjegjësitë për veprimet që lidhen me sigurinë e informacionit në DPT.

Në bazë të kësaj rregulloreje janë hartuar dhe disa politika dhe procedura në funksion të sigurisë së informacionit.

Megjithatë, nuk janë konstatuar procese monitorimi të standardizuara dhe periodike sipas rregulloreve të hartuara për mbrojtjen e asetëve dhe informacionit, për ruajtjen e integritetin të të dhënave, për disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e informacionit.

Ndaj, auditimi i vazhdueshëm i rrjetit dhe i sistemeve në përdorim duhet të jetë një proces i dokumentuar dhe vijues, për përmbushjen e objektivit të sigurisë së informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Rishikimi dhe përditësimi në vazhdimësi i rregullave dhe politikave të zbatueshme për sigurinë dhe privatësisë duhet t'i përgjigjet ritmit të inovacionit të teknologjive dhe legjislacionet në fuqi”.

1.4 AKSHI

Në zbatim të Urdhrit nr. 47, datë 19.04.2021, Zyra e Komisionerit ushtroi hetim administrativ pranë AKSHI, me objekt “*Verifikim lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, nisur nga informacionet e publikuara në median elektronike*”.

Bazuar në vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*” (në vijim, “*VKM nr. 673*”), kompetencat dhe përgjegjësitë e AKSHI përfshijnë, ndër të tjera, si vijon:

- a) Zbatimin e politikave e të strategjive, për zhvillimin e sektorit të shoqërisë së informacionit (në vijim, “*SHI*”) dhe në veçanti të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (në vijim, “*TIK*”);
- b) Bashkërendimin e programeve në fushën e SHI-së dhe në veçanti të TIK-ut;
- c) Nxitjen e investimeve në fushën e SHI-së;
- ç) Hartimin e praktikave për ushtrimin e kompetencave që i jepen ministrit nga legjislacioni në fushën e komunikimeve elektronike;
- d) Promovimin e teknologjive të reja në fushën e SHI-së;
- dh) Dhënien e kontributit në edukimin dhe nxitjen e përdorimit të TIK nga publiku.

Në zbatim të objektit të urdhrit, grupi i kontrollit i Zyrës së Komisionerit, ka kërkuar informacione dhe sqarime në lidhje me proceset përpunuese, kategoritë e të dhënave, kategoritë e subjekteve të të dhënave, garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, marrëdhëniet me palët e treta (institucione publike/private), masat për sigurinë e të dhënave personale, që AKSHI kryen gjatë aktivitetit të tij publik, në cilësinë e Kontrolluesit apo të Përpunuesit.

Informacioni i kërkuar nga AKSHI u përcoll, nga kjo e fundit, në rrugë shkresore, me shkresën nr. 704/3, datë 21.04.2021, me përmbajtjen si vijon:

- (i) **Në lidhje me kërkesën për të listuar kategoritë e të dhënave personale që përpunon AKSHI (në cilësinë kontrolluesit) dhe bazën ligjore për përpunimin e tyre, kontrolluesi disponon si vijon:**

“Siç është shpjeguar edhe në takimin e zhvilluar pranë AKSHI-t, AKSHI nuk ka rol kontrollues të të dhënave të cilat kontrollohen vetëm nga institucionet respektive të cilat i administrojnë ato.”;

- (ii) Në lidhje me kërkesën për të listuar kategoritë e të dhënave personale që përpunon AKSHI (në cilësinë kontrolluesit) dhe bazën ligjore për përpunimin e tyre, kontrolluesi disponon si vijon:**

Siç është shpjeguar edhe në takimin e zhvilluar pranë AKSHI-t, AKSHI nuk ka rol përpunues të të dhënave të cilat kontrollohen vetëm nga institucionet respektive të cilat i administrojnë ato.”;

- (iii) Në lidhje me kërkesën për të paraqitur listën e të gjithë databazave, kontrolluesi disponon si vijon:**

“Me shkresën Nr. 2728/1 Prot., datë 20.04.2021, është dërguar lista e bazave të të dhënave fizike/elektronike, të cila janë krijuar në funksion të veprimtarisë së kontrolluesit AKSHI të tilla si, kontrolle aksesi, vizitorët e portalit e-albania, sisteme CCTV, etj.”;

- (iv) Në lidhje me kërkesën për të vënë në dispozicion listën e institucioneve për të cilat AKSHI ofron asistencë teknike dhe, për secilin rast, kategoritë e të dhënave që aksesohen, kontrolluesi nuk ka disponuar me një përgjigje konkrete;**

- (v) Në lidhje me kërkesën për të shpjeguar mekanizmin e ndërthurjes së data bazave, kontrolluesi disponon si vijon:**

“Siç është shpjeguar edhe në takimin e zhvilluar pranë AKSHI-t, databazat nuk ndërthuren me njëra tjetrën por ato ndërveprojnë që një institucion i caktuar të përfitojë produktin e parashikuar nga legjislacioni në fuqi.”;

- (vi) Në lidhje me pyetjen për të dhënë informacion për formën ligjore të rregullimit të marrëdhënies me çdo institucion (kontrata, baza ligjore), kontrolluesi disponon si vijon:**

“Me shkresën Nr. 2728/1 Prot., datë 20.04.2021, është dërguar lista e databazave të të dhënave shtetërore, për të cilat janë cilësuar edhe bazat ligjore respektive të hartuara nga institucionet administruese të tyre. Format ligjore gjenden pranë institucioneve respektive.”;

- (vii) Në lidhje me nivelin e aksesit që AKSHI ka në të dhënat personale (të palëve të treta/institucioneve), kontrolluesi disponon si vijon:**

“Siç është shpjeguar edhe në takimin e zhvilluar pranë AKSHI-t, AKSHI nuk ka asnjë akses në të dhënat personale të palëve të treta/institucioneve.”;

(viii) Në lidhje me pyetjen se çfarë të dhënash përhap AKSHI (nëse është rasti), ku dhe si, si dhe bazën ligjore për këtë qëllim, kontrolluesi disponon:

“Siç është shpjeguar edhe në takimin pranë AKSHI-t, AKSHI nuk përhap të dhëna pasi nuk ka akses në të dhëna.”;

(ix) Në lidhje me kërkesën për të venë në dispozicion kontratat me mirëmbajtësit e sistemeve, kontrolluesi disponon si vijon:

“Kontratat me operatorët që kryejnë mirëmbajtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit duhet të kërkohen rast pas rasti sipas objektit të hetimit.”;

(x) Në lidhje me kërkesën për loget (logs) dhe gjurmueshmërinë e logeve (logs) për akseset në sisteme, kontrolluesi disponon si vijon:

“Loget, gjurmueshmëria e logeve për akseset në sisteme duhet të kërkohen rast pas rasti sipas objektit të hetimit dhe do të vihen në dispozicion në rast se nuk janë informacion i klasifikuar “sekret shtetëror”, i cili vihet në dispozicion vetëm pas plotësimit të të gjithë kriterëve të legjislacionit në fuqi.”;

(xi) Në lidhje me pyetjen se cilat janë institucionet që kanë akses me ligj të posaçëm në bazat e të dhënave të AKSHI-t, kontrolluesi disponon si vijon:

“Siç është shpjeguar edhe në takimin e zhvilluar pranë AKSHI-t, AKSHI nuk ka baza të dhënash pasi çdo bazë të dhënash i përket institucionit që e krijon, administron, ruan dhe përpunon atë.”.

Konstatim:

Hetimi administrativ pranë AKSHI-t është realizuar bazuar në dokumentacionin e venë në dispozicion nga ky kontrollues, si dhe në përgjigjet e tij lidhur me kërkesat/pyetjet e parashtruara në kuadër të planit të hetimit.

Zyra e Komisionerit ushtron veprimtarinë dhe kompetencat e saj, ndaj kontrolluesve, referuar, ndër të tjera, në parashikimet e nenit 30 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Konkretisht, bazuar në dispozitën e sipërpërmendur, Zyra e Komisionerit ka të drejtën e aksesit në përpunimet e të dhënave personale, si dhe ka të drejtë të mbledhë gjithë informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave mbikëqyrëse.

Më tej, bazuar në nenin 32 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çdo kontrollues është i detyruar t'i sigurojë Zyrës së Komisionerit të gjithë informacionin që ajo kërkon në përmbushjen e detyrave të saj, si dhe t'i akordojë akses në sistemin e kompjuterëve,

në sistemet e arkivimit, që kryejnë përpunimin e të dhënave personale dhe në të gjithë dokumentacionin që lidhet me përpunimin dhe transferimin e tyre.

Në çdo rast, organi publik (në këtë rast, Komisioneri) përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes.

Përgjigjet e AKSHI, në lidhje me cilësinë e saj ligjore (si kontrollues dhe/ose përpunues), rezultojnë të paqarta dhe jo në përputhje me dispozitat normative që rregullojnë veprimtarinë e këtij kontrolluesi, nga perspektiva e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përgjigje të kërkesave/pyetjeve të parashtruara në pikat (i), (ii) dhe (vii), përgjigjet e AKSHI janë, respektivisht, “[...] AKSHI nuk është Kontrollues [...]”, “[...] AKSHI nuk është përpunues [...]” dhe “[...] AKSHI nuk ka akses në të dhënat personale të palëve të treta/institucioneve”.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit konstaton se, bazuar në VKM nr. 673, kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e AKSHI-t përfshijnë, ndër të tjera, si vijon:

- *Është autoritet rregullator koordinues, përgjegjës i bazave të të dhënave shtetërore.*
- *Riorganizon dhe menaxhon strukturat përgjegjëse TIK, në institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.*
- *Garanton një nivel të lartë të sigurisë kibernetike dhe zgjidhjet ndaj incidenteve të sigurisë kompjuterike [...], si ekipi përgjegjës ndaj incidenteve të sigurisë kompjuterike për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.*
- *Ofron shërbime të përqendruara nëpërmjet teknologjisë së informacionit e komunikimit (TIK) për qeverisjen elektronike, për administratën shtetërore, qytetarët, bizneset, të cilat janë të detajuara sipas listës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.*
- *Ofron sisteme IT, infrastrukturë hardware dhe TIK për ADISA-n, në kuadër të ofrimit të shërbimeve publike në sportele fizike nga ana e saj.*
- *Ngre, mirëmban dhe administron sisteme dhe aplikacione të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK, përfshirë edhe ato të klasifikuara si “sekret shtetëror”, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.*
- *Organizon, kryen prokurimet e qendëruara dhe lidh kontratat për sistemet, pajisjet software dhe hardware, mirëmbajtjen, si dhe shërbimet e internetit dhe intranetit me*

vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, për institucionet në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, që janë nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.

- *Ofron shkëmbimin e të dhënave në mënyrë elektronike me bazat e të dhënave të ndërlidhura në platformën qeveritare të ndërveprimit, si dhe të shërbimeve elektronike në portal dhe në modulën e tij për nëpunësit e administratës publike, për çdo person fizik dhe juridik që ushtron funksionin në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas tarifave të miratuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat dhe ekonominë.*
- *Mundëson përmes platformës qeveritare të ndërveprimit shkëmbimin e të dhënave të sistemeve elektronike (baza të dhënash shtetërore) në përputhje me kushtet e siguruara, si vijon:*
 - *Çdo sistem elektronik (bazë të dhënash shtetërore) ka të drejtë të përdorë shërbimin e dërgimit të të dhënave parësore (të cilat janë informacione specifike, të mbledhura në përputhje me aktin e krijimit të bazës së të dhënave) nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit, duke pranuar transmetimin e këtyre të dhënave, nga administratori i kësaj platforme.*
 - *Transmetimi i të dhënave merret përsipër nga platforma në kohë reale dhe pa të drejtë përpunimi për shpërndarjen të marrësi i tyre me një mesazh të dhënash që është shënuar në mënyrë elektronike dhe përmban datën dhe kohën e marrjes së tyre.*
- *Përgjigjet për ngritjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve dhe aplikacioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.*
- *Zhvillon, administron dhe mirëmban infrastrukturën hardware dhe software të shërbimeve të qeverisjes elektronike, e cila përbëhet nga:*
 - *portali unik qeveritar e-Albania, platforma qeveritare e ndërveprimit për ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike, sipas tipologjisë:*

qeveri – qeveri; qeveri – qytetar; qeveri – biznes; - sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.
 - *Regjistri Kombëtar i Shërbimeve Qeveritare online.*
 - *Regjistri Kombëtar i Bazave të të Dhënave Shtetërore.*
 - *Regjistri Kombëtar i Marrëveshjeve qeveri – qeveri.*

- *qeveri – privat; qeveri – partnerë ndërkombëtarë.*
- *qendra e të dhënave qeveritare (Datacenter-i qeveritar).*
- *qendra e rivendosjes dhe/ose vazhdueshmërisë së punës së Datacenter-it qeveritar, në rast fatkeqësie (Disaster Recovery Center).*
- *qendra e vazhdueshmërisë së punës (Business Continuity Center, BCC) dhe qendra e ruajtjes së informacionit (Back-up Center), me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimeve pa ndërprerje, 24 orë në 24 orë për 7 ditë të javës.*
- *rrjeti qeveritar (Govnet).*
- *çelësi publik dhe menaxhimi i certifikatave digjitale për administratën publike dhe subjektet private. Me garancinë financiare si institucion qeveritar, AKSHI siguron pajtueshmërinë me nenin 19, të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar.*
- *Sistemi i administrimit të dokumentit elektronik, përfshirë protokollin dhe arkivin elektronik.*
- *Rregullon dhe koordinon procesin e regjistrimit të bazës së të dhënave shtetërore, me qëllim ekspozimin e të dhënave parësore, në platformën qeveritare të ndërveprimit, auditimin e bazës së të dhënave shtetërore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.*
- *Kërkon ndryshimin e sistemeve dhe të proceseve elektronike në to, si dhe krijimin e shërbimeve të reja elektronike, me qëllim ofrimin e shërbimeve publike sa më cilësore nga portali qeveritar e-Albania.*

Referuar sa më sipër, përgjigjet e AKSHI-t në lidhje me cilësinë e tij si kontrollues ose përpunues, si dhe në lidhje me aksesin në të dhëna, rezultojnë joshteruese dhe, rrjedhimisht, nuk ndihmojnë në procesin e hetimit administrativ.

Ky konstatim vlen edhe në lidhje me mosadresimin e kërkesave të parashtruara në pikat (ix), (x) dhe (xi) të planit të hetimit.

Nga ana tjetër, pavarësisht rrethanave të hetimit, Zyra e Komisionerit konstaton paqartësi dhe mungesë interpretimi të drejtë ligjor për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në lidhje me këtë konstatim, gjendet e nevojshme të sqarohen shkurtimisht konceptet kryesore të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Në bazë të nenit 3 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, *“Kontrollues” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj (pika 5).*

Ndërsa, *“Përpunues” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që përpunon të dhëna personale në emër të kontrolluesit (pika 7).*

Në dritën e këtyre përkufizimeve, cilësia e kontrolluesit bartet nga personi i cili përmbush kushtet kumulative si vijon:

- a. Përcakton (vetëm apo së bashku me të tjerë), qëllimet dhe mënyrat e përpunimit; dhe
- b. Përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale (parimi i llogaridhënies, i parashikuar në pikën 2 të nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale).

Bazuar në dispozitat e VKM nr. 673, AKSHI, në cilësinë e *zhvillueses, administrueses dhe mirëmbajtëses së infrastrukturën hardware dhe software të shërbimeve të qeverisjes elektronike, e cila përbëhet – ndër të tjera – nga portali unik qeveritar e-Albania, platforma qeveritare e ndërveprimit për ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike, sipas tipologjisë– ndër të tjera – qeveri – qytetar*, rezulton se është përcaktuese e mënyrës së përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, duke përmbushur, kështu, një nga kushtet e pikës “a” më sipër.

Nga ana tjetër, institucionet, të cilat përpunojnë (kupto: transmetojnë/përhapin të dhënat personale të subjekteve të të dhënave), në kuadër të shërbimeve që ato ofrojnë, nëpërmjet portalit e-albania, rezulton se përcaktojnë qëllimin e përpunimit (kupto: dhënien e shërbimit të kërkuar), por në lidhje me mënyrën e përpunimit këto institucione varen nga AKSHI.

Ky konfiguracion nënkupton se institucionet e administratës shtetërore, së bashku me AKSHI-n, përmbushin së bashku kriteret kumulative të germës “a” më sipër, duke konstituuar kështu figurën e bashkëkontrolluesit.

Rrjedhimisht, AKSHI, në cilësinë e bashkëkontrolluesit të të dhënave personale (si përcaktuese e mënyrës së përpunimit) është e detyruar të përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale (germa “b” më sipër).

Nëse AKSHI do të ishte vetëm në cilësinë e përpunuesit, atëherë institucionet e administratës shtetërore, infrastruktura TIK e të cilave administrohet nga AKSHI, do të kishin të drejtë të zgjidhnin të mos merrnin shërbimet e AKSHI-t për qëllime të përmbushjes së veprimtarisë së tyre, çfarë nuk është rasti, pasi në të kundërt do të vepronin në kundërshtim me dispozitat e VKM nr. 673.

Gjatë hetimit pranë DPGJC, është konstatuar se numri i subjekteve që kanë akses në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, falë aksesit që ju ka akorduar AKSHI, është më i madh sesa numri i përcaktuar në Udhëzimin nr. 463, datë 10.12.2020, të përbashkët të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrit të Brendshëm *“Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin, specifikisht sipas aneksit I, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi “Lista e institucioneve që marrin informacion, baza ligjore përkatëse, lloji dhe sasia e informacionit që jep shërbimi i gjendjes civile dhe mënyra e vënies në dispozicion të këtij informacioni” (në vijim, “Udhëzimi nr. 463”)*.

Dhënia e aksesit në një bazë të dhënash, pa plotësuar kriteret ligjore të përpunimit (në këtë rast, sa parashikohet në Udhëzimin nr. 463 në harmoni me pikën 1 të nenit 6 të Ligjit), përbën cenim ndër të tjera, të neneve 5, 6 dhe 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se dhënia e aksesit për palë të treta përbën një kategori të veçantë përpunimi të parashikuar në pikën 12 të nenit 3 të Ligjit dhe, rrjedhimisht, si çdo përpunim tjetër, edhe kjo kategori përpunimi duhet të kalojë (me sukses) testin e neneve 5 dhe 6 të Ligjit, në mënyrë që të konsiderohet i përligjur.

Nga ana tjetër, ky konstatim dëshmon se AKSHI, përveç mënyrës së përpunimit të të dhënave që gjenden në Regjistrin Kombëtar Gjendjes Civile, përcakton edhe qëllimin e aksesit në këtë regjistër, për subjektet të cilat nuk janë parashikuar në Udhëzimin nr. 463, çfarë e bën atë bashkëkontrollues të të dhënave personale që përpunohen nëpërmjet platformave të administruara prej tij.

Cilësia e bashkëkontrolluesit i atribuohet AKSHI-t edhe në përgjigjet që institucionet e administratës shtetërore objekt hetimi (DPGJC dhe DPT) kanë dhënë për Zyrën e Komisionerit.

Më tej, bazuar në VKM nr. 673, AKSHI ka edhe kompetencat si vijon:

- (i) përgjigjet për ngritjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve dhe aplikacioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK;
- (ii) organizon dhe kryen prokurimet e qendëruar dhe lidh kontratat për sistemet dhe pajisjet, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave;

- (iii) administron dhe mirëmban infrastrukturën *hardware* dhe *software* të shërbimeve të qeverisjes elektronike, e cila përbëhet– ndër të tjera - nga qendra e të dhënave qeveritare (*Datacenter*-i qeveritar), qendra e rivendosjes dhe/ose vazhdueshmërisë së punës së *Datacenter*-it qeveritar, në rast fatkeqësie (*DisasterRecovery Center*), qendra e vazhdueshmërisë së punës (*Business Continuity Center, BCC*) dhe qendra e ruajtjes së informacionit (*Back-up Center*), me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimeve pa ndërprerje.

Dispozitat e mësipërme të VKM nr. 673 i akordojnë AKSHI-t përgjegjësinë kryesore për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale që përpunohen në infrastrukturën TIK në institucionet e administratës shtetërore.

Sipas neneve 27 dhe 28 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ky detyrim i përket kontrolluesit (në këtë rast, edhe AKSHI-t si bashkëkontrollues).

Rrjedhimisht, bazuar në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, të gjithë kontrolluesit e mëdhenj kanë detyrimin të krijojnë, administrojnë dhe mirëmbajnë sistemet përkatëse të menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në rastin e institucioneve të administratës shtetërore, në dritën e parashikimeve të VKM nr. 673, rezulton se, përveç vetë institucioneve në fjalë, përgjegjëse për këtë qëllim është edhe AKSHI.

Thuajse në të gjithë institucionet e administratës shtetërore, të cilat kanë qenë objekt hetimi nga ana e Zyrës së Komisionerit, ka rezultuar mungesa e ekzistencës së SMSI, si dhe e zbatimit të detyrimeve të tjera që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me sigurinë e të dhënave.

Në këtë kontekst (sa i përket SMSI të vetë AKSHI), theksojmë se në inspektimet e fundit zhvilluar pranë AKSHI, në bazë të urdhërit nr. 165 prot., datë 09.11.2020, i cili është pjesë e raportit që i është paraqitur Kuvendit, më datë 08.02.2021, në lidhje me çështjen e sigurisë së të dhënave, Zyra e Komisionerit ka konstatuar si vijon:

“Nga verifikimet e realizuara, u konstatua se AKSHI ka miratuar një rregullore specifike për politikën e privatësisë, e cila është publikuar edhe në faqen zyrtare të institucionit.

Nga shqyrtimi i rregullores rezulton se janë parashikuar parimet e përpunimit të të dhënave, si dhe të drejtat e subjektit të të dhënave, masat organizative të sigurisë, e drejta për tu ankuar, etj.

Megjithatë, vërehet se në këtë rregullore nuk janë përfshirë të gjitha proceset përpunuese të të dhënave personale që kryen AKSHI, duke kufizuar, në këtë mënyrë, të drejtën për t'u informuar të subjekteve të të dhënave në lidhje me kategoritë e të dhënave personale, që përpunohen dhe qëllimin e përpunimit.

AKSHI rezulton të ketë deleguar shërbimin e ruajtjes fizike të ambienteve tek një subjekt privat (Përpunues). Nga analizimi i kësaj kontrate, konstatohet një mungesë e rregullave për mbrojtjen e të dhënave për këtë proces përpunues, si dhe vërehen mangësi në lidhje me elementet, detyrimet dhe garancitë ligjore të kërkuara nga dispozitat e nenit 20 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

AKSHI ka miratuar sistemin SMSI sipas standardit të sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001.

Nga shqyrtimi i dokumentave, pjesë e këtij sistemi, rezulton se janë përcaktuar procedurat dhe politikat për sigurinë e informacionit në lidhje me menaxhimin e aksesit, përdorimin e aseteve, menaxhimin e burimeve njerzore, menaxhimin e kapaciteteve të sistemeve, menaxhimin e incidenteve, vazhdimësinë e sigurisë së informacionit, etj.

Megjithatë, vërehet se në këtë institucion mungon, në strukturën organizative, një funksion i pavarur për të monitoruar dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme sistemin e implementuar.

Misioni i kësaj strukture organizative, për sigurinë e informacionit, duhet të jetë hartimi, zbatimi dhe mirëmbajtja një programi për sigurinë e informacionit që mbron sistemet, shërbimet dhe të dhënat e AKSHI-it kundër përdorimit të paautorizuar, zbulimit, modifikimit, dëmtimit dhe humbjes.

Rëndësia e një ekipi proaktiv dhe të paanshëm është faktor kyç, për kryerjen e proceseve për garantimin e sigurisë së informacionit në lidhje me menaxhimin, udhëzimet, koordinimin dhe funksionet operationale, si dhe për përcaktimin e politikave/rregulloreve për monitorimin dhe menaxhimin të sigurisë së informacionit.

Ky rol është i rëndësishëm për të monitoruar në mënyrë periodike efikasitetin e SMSI-së duke analizuar progresin e arritur dhe duke propozuar përmirësime të mëtejshme.

Përmirësimi i vazhdueshëm është një aspekt kyç i SMSI-së në përpjekjen për të realizuar dhe ruajtur konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe besueshmërinë e sigurisë së informacionit dhe duhet të jetë pjesë e integruar e objektivave të Kontrolluesve publikë.

Duke analizuar rëndësinë e AKSHI-it si institucioni qendror përgjegjës për infrastrukturën e shërbimeve elektronike qeveritare, ngritja e një strukture të pavarur dhe të kualifikuar sipas standardeve të sigurisë së informacionit luan një rol të rëndësishëm në sigurinë e të dhënave personale dhe efikasitetin e SMSI.

Me ritmin e inovacionit dhe përparimit të teknologjisë është thelbësor zhvillimi i kompetencave, veçanërisht për specialistët TIK, sipas standardeve të sigurisë ISO/IEC 27001, për të pasur njohuritë profesionale për administrimin e sistemeve në përdorim.

Duke marrë në konsideratë infrastrukturat kritike në menaxhim, Zyra e Komisionerit vlerëson se nga ky institucion duhet t'i kushtohet me shumë rëndësi monitorimit të vazhdueshëm të sistemeve, infrastrukturave dhe shërbimeve që ofrohen nëpërmjet platformes qeveritare GG (Government Gateway), shërbimet Cloud dhe infrastrukturës së çelësit publik (PKI).

Gjithashtu, strategjia e rimëkëmbjes nga katastrofat, si dhe planet që përcaktojnë vazhdimësinë e proceseve në rastet e dështimit, duhet të jenë në përputhje me nomrat e lejuara të distancave të sigurisë dhe të testohen periodikisht për të gjithë komponentët e tyre.”.

Zyra e Komisionerit nuk përjashton mundësinë që Baza e të Dhënave të jetë populluar nga të dhënat të cilat kontrollohen dhe/ose përpunohen nga institucionet objekt të këtij hetimi (dhe/ose subjektet e kontraktuara/nënkontraktuara prej tyre për ofrimin e shërbimeve të ndryshme për ngritje dhe mirëmbajtjen e sistemeve të infrastrukturës kritike, si dhe jo vetëm), rrjedhja e të cilave mund të jetë rezultat i mungesës së masave të sigurisë nga subjektet që kanë të drejtë t'i aksesojnë këto të dhëna, ose nga vetë institucionet ku këto të dhëna përbëjnë të dhëna parësore dhe/ose dytësore të bazave shtetërore të konstituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Prandaj, adresimi i konstatimeve të mësipërme merr rëndësi të jashtëzakonshme, jo vetëm për vetë AKSHI-n, por edhe për institucionet e administratës shtetërore çështjet e sigurisë të së cilave mbulohen nga ky institucion (në bazë të VKM nr. 673).

1.5 PSSH

Në zbatim të Urdhrit nr. 57, datë 05.05.2021, Zyra e Komisionerit ushtroi hetim administrativ pranë kontrolluesit PSSH, me objekt *“Verifikim lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, nisur nga informacionet e publikuara në median elektronike si dhe verifikimi i ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Komisionerit”.*

Informacioni i kërkuar nga PS, në kuadër të procesit hetimor, u vu në dispozicion të inspektorëve gjatë inspektimit në terren, më datë 14.06.2021, me përmbajtjen si vijon:

(i) Në lidhje me kërkesën për të listuar kategoritë e të dhënave personale që përpunon PSSH, kontrolluesi disponon si vijon:

“Evidentimi i të dhënave të anëtarësisë së partisë, krijimi i regjistrit të anëtarësisë së partisë dhe përpunimi i tyre nga PSSH bëhen në përputhje me parashikimet në nenin 13, kreun 3 të statutit të saj, si dhe rregulloren “Dokumentacioni në PS dhe administrimi i tij”.

Evidentimi i të dhënave dhe përpunimi i tyre ka si qëllim nxjerrjen e të dhënave që kanë të bëjnë me numrin e anëtarësisë së partisë, numrin e anëtarësisë së partisë për

çdo OS-QV, njësi administrative, bashki, raportet moshore dhe gjinore, gjendjen e arsimit të saj, të profesioneve të punësimit të mundësisë për të siguruar kontakt të vazhdueshëm me anëtarësinë, OS, KS dhe AS të bashkive për të përcjellë mesazhe, detyra, problematika që lidhen me veprimtarinë konkrete të tyre në terren.

Kategoritë e të dhënave personale që përpunon Partia Socialiste janë kategoritë që përfshihen në formularin e aplikimit të personit që kërkon të pranohet në parti dhe konkretisht ka të bëjë me këto rubrika:

- a. Rubrika e personalizimit ku përfshihen: emër, atësi, mbiemër, vendlindje, datëlindje, gjinia, numri personal i ID;
- b. Rubrika e arsimimit dhe profesioni i fituar prej tij;
- c. Rubrika e punësimit, sektori dhe pozicioni në punë;
- d. Rubrika e anëtarësimit, që ka të bëjë me datën, muajin, vitin e pranimit në parti;
- e. Adresat e kontaktit ku përfshihen, nr i celularit ose telefoni fiks, adresa e e-mailit, linku i facebook, WhatsApp, adresa e banimit, numri i QV ku voton, njësi administrative dhe bashkia ku ka lejen e banimit dhe banon.”;

(ii) Në lidhje me kërkesën për të paraqitur listën e të gjithë databazave, kontrolluesi disponon si vijon:

“Baza e të dhënave për çdo anëtar mbi bazën e të cilave krijohet regjistri i anëtarësisë së partisë janë të dhënat që çdo anëtar partie plotëson në formularin e anëtarësimit të tij në parti.

Çdo individ që kërkon të pranohet në parti paraqitet tek bashkëkryetarët e OS, ose tek kryetari i KS të NJA, ose tek drejtuesit e PS të bashkisë përkatëse, bën kërkesën me gojë ose me shkrim që kërkon të pranohet në parti. Pas kësaj i vihet në dispozicion formular i anëtarësimit, të cilën e plotëson sipas rubrikave që përmban ai, e firmos dhe e depoziton tek kryetari i partisë i bashkisë, i cili bën regjistrimin e tij në regjistrin e anëtarësisë së partisë të bashkisë përkatëse.”;

(iii) Në lidhje me institucionet nga të cilat merren të dhënat, rolet dhe personat që kanë akses në të bazën e të dhënave dhe mënyrën e aksesimit, kontrolluesi disponon si vijon:

“Formularët e anëtarësisë së partisë bëjnë pjesë në dokumentacionin e përhershëm të AS të bashkive dhe administrohen prej tyre. Përgjegjës për administrimin e tyre janë kryetari dhe sekretari organizativ i PS të bashkisë. Aksesin për të hyrë në rregjistrin elektronik të partisë dhe për të bërë lëvizjet përkatëse (pranimet e reja, largimet nga partia, çrregjistrimet, vdekjet etj) e ka vetëm kryetari i partisë i bashkisë.

Në dokumentacionin e kryetarit të OS bën pjesë një listë e anëtarëve të partisë të OS me të dhëna të reduktuara dhe konkretisht me emër, mbiemër, vendbanim, dhe numër kontakti (cel/whatsapp dhe adresë e facebook). Kryetari i Këshillit Socialist të NJA ka në administrim listat e anëtarësisë së partisë të OS në territorin e njësisë administrative që mbulon me të dhënat e mësipërme. Regjistri elektronik i anëtarësisë së partisë të bashkisë përfshin anëtarësinë e partisë të bashkisë, sipas OS dhe njësisë administrative në përbërje të bashkisë me të dhënat e plota sipas formularit të pranimit për cdo anëtar partie dhe administrohet në AS të bashkisë nga kryetari i PS të bashkisë.

Në bazën e të dhënave të anëtarësisë së partisë ka akses kryetari i partisë i bashkisë në nivel vendor. Në nivel qendror në bazën e të dhënave të anëtarësisë së partisë ka akses: Kryetari i Partisë Socialiste, Sekretari i Përgjithshëm dhe Sekretari Organizativ.

Ekstratin e “Listës së Zgjedhësve”, me kërkesë të përfaqësuesit politik në KQZ, “P.S.SH.” e merr si subjekt politik me të dhënat që ka KQZ dhe ja shpërndan strukturave në OS, KS dhe në nivel bashkie për analizë të brendshme politike.”;

- (vii) Në lidhje me pyetjen se cilat janë masat e sigurisë fizike dhe teknike të sistemeve të vetëadministruara, kontratat dhe raportet me mirëmbajtësit e sistemeve, si garantohen të drejtat e subjekteve të të dhënave, a janë paraqitur kërkesa nga subjektet e të dhënave për fshirjen e të dhënave personale, si dhe plotësimi i detyrimeve në cilësinë e kontrolluesit, kontrolluesi në fjalë nuk disponoi me informacion konkret.**

Konstatim:

Referuar deklarimeve të përfaqësuesve, konstatimeve në vend, si dhe të dhënave të web-ndërfaqes *online* të listës së zgjedhësve që administrojnë PSSH, rezulton se ky kontrollues disponon dy kategori bazash të dhënash. Konkretisht, njëra konsiston në të dhënat e anëtarëve të partisë dhe e dyta konsiston në të dhënat e listës së zgjedhësve.

Të dyja bazat e të dhënave mund të aksesohen nga një web-ndërfaqe e vetme *online*. Web-ndërfaqja *online* është e pajisur me ‘emër përdoruesi’ dhe ‘fjalëkalim’ për çdo nivel përdoruesi.

Nga pikëpamja teknike, në nivel përdoruesi (në rastin konkret për Bashkinë Tiranë), mund të aksesohen të dyja bazat e të dhënave, si ajo e anëtarëve, po ashtu edhe ajo e votuesve.

Serveri në të cilin është vendosur baza e të dhënave, të cilat aksesohen nëpërmjet web-ndërfaqes *online*, është e instaluar lokalisht, në selinë e kontrolluesit.

Bazuar në formularin e anëtarësisë, të vënë në dispozicion gjatë hetimit pranë PSSH, kategoritë e të dhënave të anëtarësisë që përpunon ky kontrollues janë si vijon:

1. Emër;
2. Atësi;
3. Mbiemër;
- ç. Vendlindje
4. Datëlindje;
5. Gjinia;
6. Numri personal i identifikimit;
7. Arsimi:
 - Shkollë 9 vjeçare;
 - Shkollë e mesme;
 - Universitar;
 - Pasuniversitar;
 - Tituj shkencorë;
8. Punësimi:
 - Sektor shtetëror (pozicioni)
 - Sektor privat (pozicioni)
 - Vetëpunësim;
 - I/E papunë;
 - Student;
 - Pension
9. Data e pranimit në PSSH;
10. Numër celulari;

11. E-mail;
12. Linku i Facebook;
13. Adresa e banimit;
14. Numri i qendrës së votimit;
15. Njësia administrative;
16. Bashkia.

Më tej, kategoritë e të dhënave të listës së zgjedhësve, të cilët ushtrojnë të drejtën e tyre në Bashkinë Tiranë, referuar web-ndërfaqes *onlinetë* kontrolluesit, janë si vijon:

1. Kodi i zgjedhësit (sipas referencës së databazës);
2. Emër;
3. Atësi;
4. Mbiemër;
5. Qendër votimi;
6. Numër liste zgjedhore;
7. Kod banese;
8. Datëlindje;
9. Moshë;
10. Census (informacion në lidhje me bindjen politike);
11. Numër telefoni
12. Anëtarësi;
13. Patronazhuesi.

Përfaqësuesit e PSSH deklaruan se kategoritë e të dhënave të zgjedhësve janë të dhënat e marra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me kërkesë të përfaqësuesit ligjor të PSSH, të atashuar pranë këtij institucioni. Lista merret në format DVD dhe përditësohet në bazën

qendrore të të dhënave të zgjedhësve. Të dhënat e tjera të shtuara, si numër telefoni dhe të dhëna preference (census), janë të dhëna të shtuara nga patronazhuesi.

Të dhënat në lidhje me preferencën politike (census) dhe nr. telefoni, janë mbledhur nga sistemi 'patronazhuesi', referuar udhëzimit të brendshëm datë 11.01.2021, drejtuar strukturave të subjektit politik.

Sistemi 'patronazhuesi' është i përbërë nga anëtarët dhe simpatizantët e partisë. Patronazhuesve ju vihet në dispozicion lista e zgjedhësve që secili prej tyre ka në patronazh dhe detyra e tyre është përmbyllja e procesit të censusit dhe mbajtja e kontakteve me zgjedhësit në patronazh, deri në përfundim të votimit, si dhe kontaktimi i zgjedhësve për të përcjellë mesazhe elektorale, evidentimin e problemeve që lindin gjatë fushatës, etj.

Më tej, kontrolluesi ndërvepron me subjektet e të dhënave nëpërmjet faqes së internetit www.ps.al. Në këtë faqe interneti janë parashikuar disa mënyra kontaktimi, ndër të tjera, nëpërmjet rubrikave të tilla si 'Na kontakto' dhe 'Rekomando shokun tënd'.

Në të dyja rubrikat, në mënyrë që të përcillen të dhënat përkatëse është e nevojshme që dërguesi të japë pëlqimin e tij, duke klikuar më parë butonin e caktuar, i cili informon atë si vijon: "Duke përdorur këtë website dhe këtë formular, ju bini dakord që të dhënat tuaja personale të përdoren për qëllime komunikimi gjatë fushatës tonë elektorale".

Gjithashtu, rubrika 'Rekomando shokun tënd' ka për qëllim rekomandimin e një personi të tretë (i cili mund të jetë ose jo, anëtar i PSSH), duke vendosur të dhënat personale si emër, mbiemër, e-mail dhe numër telefoni.

Sa më sipër, rezulton se www.ps.al ka mundësuar një mekanizëm të tillë, i cili *a priori* mbledh të dhëna personale, pa pëlqimin e shprehur të subjektit përkatës të të dhënave.

Nga krahasimi i të dhënave që përpunon PSSH, bazuar në formularin e anëtarësisë në nivel vendi, me ato të Bazës së të Dhënave, rezulton se përputhen plotësisht në 8 kategori të dhënash (emri, atësia, mbiemri, numri personal, datëlindja, vendlindja, numri i telefonit, qendra e votimit), si dhe kanë përafërsi në një kategori, në lidhje me punësimin, e cila në Bazën e të Dhënave është e detajuar, ndërsa në bazën e të dhënave sipas formularit të anëtarësisë në PSSH është e natyrës së përgjithshme/gjenerike.

Në lidhje me këtë përpunim, Zyra e Komisionerit konstaton se të dhënat personale të përpunuara nëpërmjet plotësimit dhe nënshkrimit të formularit të anëtarësisë (në rang vendi), bazohen në pëlqimin e shprehur të anëtarit përkatës dhe, kështu, *prima facie* nuk rezulton në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, pasi ky përpunim bazohet në pëlqimin e shprehur të subjektit të të dhënave (germa "a" e pikës 1 të nenit 6 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale).

Të dhënat e përpunuara sipas rubrikave të formularit të anëtarësisë të PSSH popullojnë një bazë të dhënash (regjistrin e anëtarëve në rang vendi), e cila nuk rezulton e njëjtë me ato të Bazës së të Dhënave, qoftë nga perspektiva e formatit teknik, qoftë nga përmbajtja

përkatëse. Rrjedhimisht, nga hetimi nuk rezultoi i mundur konstatimi i gjurmëve dhe/ose elementëve indikativë që mund të krijonin dyshimin e arsyeshëm se kjo bazë të dhënash ka rrjedhur në mënyrë të paligjshme dhe është bërë publike, duke u bashkëshoqëruar me të dhënat e tjera të Bazës së të Dhënave.

Nga ana tjetër, bazuar në deklaratimet e përfaqësuesve të PSSH (përgjigjja e pyetjes në pikën (iii) më sipër), rezulton se *“Formularët e anëtarësisë së partisë bëjnë pjesë në dokumentacionin e përherëshëm të AS të bashkive dhe administrohen prej tyre. Përgjegjës për administrimin e tyre janë kryetari dhe sekretari organizativ i PS të bashkisë. Aksesin për të hyrë në regjistrin elektronik të partisë dhe për të bërë lëvizjet përkatëse (pranimet e reja, largimet nga partia, çregjistrimet, vdekjet etj) e ka vetëm kryetari i partisë i bashkisë.”*

Kësisoj, të dhënat e përgjithshme të anëtarësisë, të plotësuara me kategoritë shtesë të të dhënave sipas listës së zgjedhësve (kodi i banesës, censusi, patronazhuesi), popullojnë një bazë të dhënash të natyrës *ad hoc*, e cila përdoret gjatë një fushate zgjedhore të caktuar.

Kjo bazë të dhënash, rezulton të përkohë në 11 kategori të dhënash me ato të Bazës së të Dhënave. Konkretisht, emri, atësia, mbiemri, numri personal, datëlindja, vendlindja, numri i telefonit, qendra e votimit, kodi i banesës, censusi, patronazhuesi. Duke shtuar këtu edhe kategorinë e përafërt (punësim – kompani), numri total shkon në 12 kategori të dhënash, të cilat përbëjnë afërsisht 67% përputhshmëri.

Një tjetër element ngjashmërie lidhet me faktin se të dhënat e Bazës së të Dhënave rezultojnë të përmbajnë të dhënat e zgjedhësve në një territor të caktuar.

Faktet dhe rrethanat e hetimit administrativ nuk krijojnë kushtet për të evidentuar dhe provuar, në terma dhe hapa konkretë hetimorë, krijimin dhe përdorimin e Bazës së të Dhënave nga asnjë subjekt hetimi administrativ. Por ngjashmëria e saj, në përmbajtje dhe territor, me të dhënat e përftueshme nga kombinimi i listës së anëtarësisë së PSSH në rang vendi, me të dhënat e listës së zgjedhësve të një territori të caktuar (e cila përmban, ndër të tjera, edhe përbërës zgjedhorë që origjinojnë nga të dhënat që DPGJC dhe KQZ vënë në dispozicion të subjekteve zgjedhore, në përputhje me nenin 60 të Kodit Zgjedhor), nuk e përjashton mundësinë që Baza e të Dhënave të jetë krijuar dhe përdorur nga nivele lokale organizimi politik-zgjedhor dhe/ose organizime apo struktura të kandidatëve të veçantë (apo subjekteve të kontraktuar/nënkontraktuar prej tyre për ofrim shërbimesh në kuadër të fushatës zgjedhore dhe jo vetëm), në kundërshtim edhe me vetë rregullat e brendshme të organizimit të këtij Kontrolluesi.

Mosekzistenca e një baze të dhënash, të ngjashme me Bazën e të Dhënave, në asnjë territor tjetër të organizimit politik të PSSH në vend, përjashton këtë kontrollues nga dyshimi për autorësinë në krijimin dhe administrimin e Bazës së të Dhënave. Por, nga ana tjetër, meqenëse në Bazën e të Dhënave ekzistojnë edhe të dhëna të anëtarëve të këtij subjekti politik, përpunimi origjinar i të cilave është realizuar me vullnetin e tyre, bartja dhe administrimi i këtyre të dhënave në Bazën e të Dhënave nënkupton një përdorim të

paautorizuar të tyre nga persona që mund të kenë patur akses në to, në tejkalim të qëllimit të përpunimit.

Rrjedhimisht, Zyra e Komisionerit konstaton mungesën e masave tekniko-organizative për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave të anëtarëve të PSSH, të cilat rezultojnë të përpunuara edhe në Bazën e të Dhënave. Veçanërisht problematike është mungesa e sistemit të gjurmueshmërisë së aksesit në të dhënat personale të përpunuara prej këtij kontrolluesi, si dhe qarkullimit të tyre.

Më tej, Zyra e Komisionerit vlerëson se përdorimi i rubrikës ‘*Rekomando shokun tënd*’ në faqen e internetit www.ps.al, bart elementë problematikë sa i përket ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave nëpërmjet këtij mekanizmi. Përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, për qëllime të organizimit politik, duhet realizuar në përputhje me parimet e parashikuara në nenin 5 dhe kriteret e ligjshmërisë të parashikuara në nenin 6 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për këtë qëllim, Zyra e Komisionerit ka miratuar dhe publikuar Udhëzimin nr. 35, datë 07.05.2013, “*Për përpunimin e të dhënave personale për qëllime të fushatës zgjedhore*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 35*”), i cili synon të adresojë përpunimin e të dhënave personale nga kandidatët e subjekteve politike gjatë një fushate zgjedhore.

Pavarësisht se Udhëzimi nr. 35 nuk adreson konkretisht përpunimin e të dhënave nga subjektet politike, por vetëm nga kandidatët përkatës, ai përbën një bazë të arsyeshme për zbërthimin, interpretimin dhe zbatimin e drejtë dhe korrekt të dispozitave të neneve 5 dhe 6 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në kuadër të veprimtarive përpunuese për qëllime të organizimit dhe mbarëvajtjes së një fushate zgjedhore.

Në këtë kontekst, pika 1 e nenit 3 të Udhëzimit nr. 35 detyron kontrolluesin të informojë qartësisht subjektet e të dhënave për qëllimin e mbledhjes së të dhënave personale dhe për mënyrën e përdorimit të tyre.

Nëse kontrolluesi përpunon të dhëna personale për qëllime të fushatës zgjedhore në mënyrë manuale apo elektronike, ai duhet të njoftojë paraprakisht Komisionerin (neni 5 i Udhëzimit nr. 35), duke përditësuar formularin përkatës të njoftimit.

Udhëzimi nr. 35 parashikon, gjithashtu, kriterin ligjor të pëlqimit, si një element thelbësor në rast përpunimi të të dhënave sensitive, referuar pikës 2 të nenit 6 të tij.

Sa më sipër, përdorimi i rubrikës ‘*Rekomando shokun tënd*’ rezultojnë tejet problematik dhe i paragjyqeshëm sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Për këtë arsye, një përpunim eventual të dhënash nëpërmjet rubrikës në fjalë, sipas të gjitha gjasave, do të rezultonte në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale (nenet 5, 6 dhe 18 të Ligjit). Për këtë arsye, duhet të ndalet përdorimi i tij *a priori* (pa marrë masat e nevojshme për informimin dhe marrjen e pëlqimit të subjektit të të dhënave).

Më tej, Zyra e Komisionerit konstaton se PSSH, si subjekt i madh përpunues, nuk ka krijuar sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale, siç parashikohet nga dispozitat detyruese të Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Ekzistenca e SMSI, me të gjithë elementët e saj (përfshirë, por pa u kufizuar, vlerësimin e ndikimit në privatësi, politikat e sigurisë së informacionit e të tjerë) përveç përmbushjes së një detyrimi formal-ligjor, përbën një garanci të arsyeshme për shmangien dhe/ose për restaurimin e situatave të rrjedhjes së të dhënave (*data breach*), siç mund të jetë rasti i qarkullimit të paligjshëm të të dhënave të anëtarëve të PSSH në Bazën e të Dhënave objekt hetimi administrativ.

Krijimi, administrimi dhe mirëmbajtja e SMSI, në përputhje me standardin ISO 27001 (të përditësuar) siç parashikohet në udhëzimin nr. 48, datë 14.09.2012, të Komisionerit për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “*Për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 48*”), veçanërisht për një organizatë politike (e cila, bazuar në nenin 7 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale) përpunon edhe të dhëna sensitive të anëtarëve të saj, adreson kërkesat dhe detyrimet që burojnë për çdo kontrollues nga parimi i llogaridhënies/përgjegjësisë, i parashikuar në pikën 2 të nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

1.6 Konkluzione dhe rekomandime

Në konkluzion të hetimit administrativ kryesisht, me objekt “*Verifikimi lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, nisur nga informacionet e publikuara në median elektronike*”, të ndërmarrë pranë 5 kontrolluesve (Lapsi.al, DPGJC, AKSHI, DPT, PSSH), për gjithë sa parashtruar në këtë Relacion, shoqëruar me kompleksitetin jashtëzakonisht të madh të çështjes objekt hetimi, përhapjen e Bazës së të Dhënave në një numër tashmë të papërcaktuar marrësish, si dhe mungesën e resurseve dhe kapaciteteve të mjaftueshme teknike dhe të burimeve njerëzore, për të adresuar një cenim të dhënash (*data breach*) të këtyre përmasave, nuk rezulton i mundur identifikimi i burimit të krijimit, administrimit dhe përhapjes së Bazës së të Dhënave.

Zyra e Komisionerit ka insistuar, në vazhdimësi, për të rritur ndërgjegjësimin dhe asistuar kontrolluesit publikë në drejtim të përmbushjes së detyrimeve të tyre ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale që ata përpunojnë në kuadër të ushtrimit të funksioneve dhe detyrave të tyre, si dhe përmbushjes së misionëve përkatëse institucionale.

Ende konstatohet një nivel i pamjaftueshëm njohurish, si dhe mungesë e qartë vullneti institucional për të përmbushur dhe respektuar dispozitat detyruese të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Një situatë e tillë dëshmohet, gjithashtu, edhe në katalogun e normave që rregullojnë, veçanërisht, marrëdhëniet midis AKSHI-t dhe institucioneve të administratës shtetërore,

interpretimi i ngushtë i të cilave ka shkaktuar paqartësi dhe mungesë sigurie juridike sa i përket cilësive që bart secila palë (kontrollues dhe/ose përpunues) në suazën e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në këtë kontekst, bazuar në inspektimet objekt të këtij Relacioni, si dhe hetimet administrative të mëhershme, ndër të tjera, në kuadër të Rezolutës së Kuvendit, datë 21.05.2020, konstatohet një mungesë vëmendjeje dhe përpjekjesh nga ana e kontrolluesve publikë (institucioneve që këtë cilësi jua ngarkon ligji përkatës sektorial), jo vetëm kundrejt njohjes dhe adresimit të aspekteve materiale të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale (të tilla si, parimet, kriteret ligjore, si dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave), por, çfarë është më e rëndësishme, edhe në drejtim të masave tekniko-organizative, të cilat synojnë të garantojnë sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale.

Në lidhje me këtë aspekt, vërehet një mungesë koordinimi dhe bashkëpunimi midis këtyre institucioneve, çfarë ka rezultuar edhe në kuadër të hetimit më të fundit administrativ, ku palët vijojnë të shmangin përgjegjësinë nga vetja, duke ia ngarkuar këtë të fundit njëra-tjetrës.

Zyra e Komisionerit vlerëson se dispozitat ligjore që rregullojnë përgjegjësitë e AKSHI-t në lidhje me infrastrukturën kritike të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, në dispozicion të institucioneve publike, nuk përbëjnë shkak ligjor dhe justifikim për apatinë faktike që karakterizon këto të fundit në lidhje me ushtrimin e kompetencave të tyre si kontrollues dhe, rrjedhimisht, përcaktues të qëllimeve përkatëse të përpunimit të të dhënave personale.

Neni 35 i Kushtetutës dhe dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale zbatohen ndaj këtyre kontrolluesve pavarësisht rolit të tyre faktik në administrimin e bazave të tyre të të dhënave, si dhe përcaktimin e mjeteve të përpunimit të të dhënave personale.

Nga ana tjetër, dispozitat ligjore që rregullojnë përgjegjësitë e AKSHI-t në lidhje me infrastrukturën kritike të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (veçanërisht, VKM nr. 673), në dispozicion të institucioneve publike, nuk përbëjnë shkak ligjor dhe justifikim për vetë AKSHI-n për të moskonsideruar dhe anashkaluar cilësitë prej kontrolluesi të çdo institucioni të administratës shtetërore, infrastrukturën kritike të të cilit mirëmban dhe/ose administron. Në lidhje me këtë çështje vlen të theksohet tejkalimi i dispozitave të Udhëzimit nr. 463, sa i përket aksesit që palë të treta kanë në të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile³.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit konstaton një mosrespektim sistematik nga të gjithë kontrolluesit publikë, objekt hetimi, të germës “a” të pikës 1 të nenit 31 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili implikon përgjegjësinë e këtyre të fundit për të kërkuar mendim/opinion nga Zyra e Komisionerit për projekt-aktet, ligjore dhe

³Shih konstatimet në faqet 18 dhe 31 të këtij Relacioni.

nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat personale, si dhe projektet që kërkohen të zbatohen nga këta kontrollues, vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë.

Më tej, siç rezulton edhe nga hetimet administrative të kryera nga Zyra e Komisionerit, në përmbushje të detyrave të lëna nga Rezoluta e Kuvendit, datë 21.05.2020, për qëllim të së cilës i është paraqitur një raport i posaçëm Kuvendit, më datë 08.02.2021, në pjesën më të madhe të kontrolluesve publikë, aspekti rregullator i mbrojtjes së të dhënave personale në proceset përpunuese përmes teknologjisë së informacionit është i veçuar nga rregullat për proceset e tjera përpunuese të të dhënave.

Në këtë kuadër, institucionet e administratës shtetërore që përpunojnë të dhëna personale duhet të parashikojnë në mënyrë konkrete, të gjitha proceset përpunuese, në akte të mirëfillta rregullatorë që garantojnë ruajtjen, sigurinë, dhe mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se problematikat e evidentuara në këto institucione të administratës shtetërore, lidhen me mungesën e njohurive ligjore dhe teknike dhe sensibilizimin mbi detyrimet që parashikon në tërësi legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa i përket marrëdhënieve kontraktore që institucionet e administratës shtetërore (në cilësinë e Kontrolluesit) lidhin me palë të treta (në cilësinë e përpunuesit) për delegimin e shërbimeve të ndryshme, ku në thelb të tyre ka edhe përpunim të të dhënave personale, vërehen mangësi në adresimin e elementeve, detyrimeve dhe garancive ligjore të sanksionuara në nenin 20 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit rekomandon që, në vijimësi, institucionet publike, në fazën e hartimit të kontratave me palët e treta, të parashikojnë në përmbajtje të tyre edhe elementet e nenit 20 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Udhëzimit nr. 19.

Zyra e Komisionerit ka konstatuar se kontrolluesit kanë hartuar dhe miratuar (*pro forma*) akte të brendshme rregullatore lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, por këto akte disponojnë rregullime të përgjithshme, lidhur me menaxhimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit të subjekteve të të dhënave, të padetajuara rregullisht në lidhje me masat tekniko-organizative të përshtatshme dhe të zbatueshme për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe sensitive, kriteret e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave, masat për garantimin e gjurmueshmërisë dhe kontrollit të veprimeve të personave/personelit që ka pasur dhe/ose ka akses në këto të dhëna, si dhe për mënyrën e shkatërrimit të tyre, kur të jetë përmbushur qëllimi i përpunimit të tyre.

Veçanërisht në lidhje me dhënien e aksesit në të dhënat personale, gjejmë rastin të rritshëm qëndrimin tonë të vazhdueshëm si autoritet mbikëqyrës, se ky veprim/përpunim, edhe kur është i autorizuar sipas ligjit, nuk nënkupton

domosdoshmërisht dhe gjithnjë një akses të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në të dhënat e kërkuara.

Dhënia e një aksesit të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në të dhënat personale, pavarësisht se mund të jetë parimisht e autorizuar me ligj, mund të sjellë një përpunim të dhënash në tejkalim të qëllimit të veprimtarisë dhe/ose detyrës për të cilën ligji e autorizon një kontrollues (autoritet/institucion) të caktuar për të patur akses në të dhënat personale të administruara nga një kontrollues (autoritet/institucion) tjetër dhe anasjelltas.

Për këtë arsye, në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria me parimin e ligjshmërisë së përpunimit, të përcaktuar në gjuhën “a” të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe, rrjedhimisht, të parandalohen cenime eventuale të sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave si rezultat i përpunimeve të mundshme ekseseve (në tejkalim të qëllimit), sikundër kërkohet nga dispozitat e neneve 27 dhe 28 të këtij ligji, si dhe Udhëzimi nr. 47 i Komisionerit, është e domosdoshme që kontrolluesit të marrin masa konkrete (i) për sigurimin e gjurmueshmërisë së aksesit në të dhëna, si dhe (ii) përcaktimin e niveleve të aksesit në përputhje me dispozitat ligjore që e autorizojnë atë, në harmoni të plotë me objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së kontrolluesit (autoritetit/institucionit) që i është akorduar ky akses.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit rekomandon që nga ana e kontrolluesve të ndërmerren në mënyrë të menjëhershme nisma për të evidentuar fillimisht të gjitha proceset përpunuese dhe më pas të përshtatin rregulloret ekzistuese ose hartojnë rregullore të brendshme që të parashikojnë masa konkrete teknike organizative në referim dhe zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit dhe për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri për sektorë të ndryshëm.

Në këtë kuadër, është i nevojshëm një angazhim më serioz i këtyre institucioneve, në drejtim të trajnimit të punonjësve që kanë akses në të dhënat personale dhe mbikëqyrin proceset përpunuese dhe në drejtim të konsolidimit të praktikave dhe legjislacionit specifik që rregullon veprimtarinë e tyre.

Në këtë kuadër, rezulton i domosdoshëm investimi në kapacitete të burimeve njerëzore dhe teknike, si dhe planifikimi i burimeve të nevojshme financiare.

Më tej, mbetet detyrë e kontrolluesve, në përputhje me parashikimet e gjuhës “a” të nenit të pikës 1 të nenit 31 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për të konsideruar dhe respektuar përgjegjësinë taksative të Zyrës së Komisionerit për dhënien e mendimeve lidhur me projekt-aktet, ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat personale, si dhe, sidomos dhe veçanërisht, në lidhje me projekte që planifikohen, ndërmerren dhe/ose kërkohen të zbatohen nga kontrolluesit (qoftë vetëm, qoftë në bashkëpunim me të tjerët). Theksojmë se, në të shkuarën e afërt, janë konstatuar raste projektesh të vëna në zbatim nga institucione qendrore, të cilat ushtrojnë edhe detyra jetike për shtetin (si menaxhimi buxhetor dhe menaxhimi i financave publike), të cilët rezultojnë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu mbetet e një rëndësie themelore nevoja për të modernizuar infrastrukturën dhe aktet rregullatore që lidhen me sistemet dhe bazat e të dhënave.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit vlerëson se nevojiten përpjekje të vazhdueshme në aspektin e garantimit të sigurisë teknike dhe organizative të të dhënave, si dhe krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të SMSI, në përputhje me parashikimet detyruese të Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Pjesa më e madhe e Kontrolluesve nuk kanë venë në zbatim mekanizmat e nevojshëm për kontrollet dhe monitorimin e aktiviteteve të TIK, me qëllim zhvillimin, operimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Rezultatet e kontrolleve të vazhdueshme të Zyrës së Komisionerit kanë treguar se ka vështirësi në menaxhimin e burimeve të teknologjisë së informacionit. Menaxhimi i aktiviteteve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit nuk është bazuar mjaftueshëm në politika, procedura dhe procese operimi të përshtatshme për sigurinë e informacionit.

Janë konstatuar mungesa në strategji dhe plane për zbatimin e SMSI-së që përfshin të gjithë komponentët e një sistemi të kompletuar për menaxhimin e sigurinë së informacionit, në përputhje me dispozitat e udhëzimeve të sipërpërmendura.

Përveç mungesës së një strategjie për SMSI-në, e cila konsiston në zbatimin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj, vihet re mungesa e një strukture të pavarur për të kryer këtë funksion. Ky rol është i rëndësishëm për të monitoruar në mënyrë periodike efikasitetin e SMSI-së, duke analizuar progresin e arritur dhe duke propozuar përmirësime të mëtejshme.

Përmirësimi i vazhdueshëm është një aspekt kyç i SMSI-së në përpjekjen për të realizuar dhe ruajtur konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe besueshmërinë e sigurisë së informacionit dhe duhet të jetë pjesë e integruar e objektivave të Kontrolluesve publikë.

Veçanërisht, në lidhje me SMSI, Zyra e Komisionerit rekomandon si vijon:

- (i) Hartimin e strategjisë për SMSI, bazuar në parimet e sigurisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (konfidencialiteti, integriteti, disponueshmëria, besueshmëria), sipas standardit ISO/IEC 27001;
- (ii) Ngritjen e strukturave monitoruese për SMSI-të dhe përmirësimi i vazhdueshëm i objektivave të sigurisë;
- (iii) Trajnimin e vazhdueshëm të stafit në lidhje me standardet ndërkombëtare (veçanërisht, atë ISO/IEC 27001) të sigurisë së informacionit dhe privatësisë;

- (iv) Projektimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të sigurisë së rrjetit dhe enkriptimi i të dhënave gjatë transferimit të tyre në të gjitha kanalet (*HTTPS, IPSec, TLS, PPTP, SSH*);
- (v) Krijimin e një regjistri të plotë të pajisjeve (aseteve) të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në përdorim, duke analizuar rëndësinë e të dhënave personale që këto asete ruajnë dhe përpunojnë.

Centralizimin e të gjitha asetëve me anë të të cilave kryhet përpunim i të dhënave personale dhe monitorimi periodik i tyre, si dhe zbatimin dhe monitorimin e politikave për instalimin, aksesin dhe përditësimin e pajisjeve me anë të të cilave kryhet përpunim i të dhënave personale;

- (vi) Zbatimin e politikave për kontrollet (fizike dhe teknike) dhe kufizimi i përdoruesve sipas nevojave për punë, si dhe auditimin periodik i sistemeve dhe rrjetit bazuar mbi matricën e akseseve. Përdorimin e *Multifactor Authentication* (MFA) në strukturat kritike dhe ato që përmbajnë të dhëna sensitive;
- (vii) Kontrollin nëpërmjet skanimeve, në mënyrë sistematike, të infrastrukturës kritike;
- (viii) Zbatimi i një plani për vazhdimësinë e sigurisë së informacionit (*disaster recovery plan*) dhe testimi në mënyrë periodike i të gjithë komponentëve të tij;
- (ix) Vlerësimin e përputhshmërisë së SMSI me standardin ISO/IEC 27001 në përputhje me Udhëzimin nr. 48 të Komisionerit, nëpërmjet auditimit periodik dhe mekanizmit të certifikimit për këtë qëllim.

Rekomandimet e mësipërme në lidhje me aspekte të sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave vlejné edhe për kontrolluesit jopublikë, subjekte të këtij hetimi administrativ dhe jo vetëm.

Sa i përket Lapsi.al, edhe pse ky kontrollues është subjekt hetimi penal nga SPAK, Zyra e Komisionerit e gjen me vend të tërheqë vëmendjen e këtij subjekti, sidomos, në lidhje me respektimin e parimeve të mjaftueshmërisë dhe proporcionalitetit të të dhënave të publikuara.

Në cilësinë e tij si media elektronike, kontrolluesi në fjalë është i detyruar të veprojë në përputhje me parimet në fjalë, në mënyrë që, krahas lirisë së shprehjes, të respektojë edhe të drejtën e subjekteve të të dhënave për një jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave të tyre personale, siç sanksionohet nga neni 35 i Kushtetutës.

Në lidhje me këtë çështje, Zyra e Komisionerit sjell në vëmendje publikimin joproporcional dhe, sipas të gjitha gjasave, në tejkalimin të parimit të mjaftueshmërisë, të të dhënave të 1800 punonjësve dhe oficerëve të policisë në faqen e internetit [www.lapsi.al\(https://lapsi.al/2021/04/14/emrat-1800-police-te-raportuar-nga-patronazhistet-e-rilindjes-votat-e-sigurta-mes-shefave/\)](http://www.lapsi.al(https://lapsi.al/2021/04/14/emrat-1800-police-te-raportuar-nga-patronazhistet-e-rilindjes-votat-e-sigurta-mes-shefave/)).

Publikimi i të dhënave të tilla, në një shkallë kaq të gjerë, si dhe, veçanërisht, për shkak të veçorive dhe rrethanave delikate që shoqërojnë detyrën e punonjësit dhe oficerit të policisë në ushtrimin e detyrave përkatëse, kërkon një kujdes dhe vlerësim të saktë të motivit që qëndron në themel të këtij publikimi, i cili, në asnjë rast, nuk mund të tejkalojë kufirin e interesit publik.

Në këtë kontest, Zyra e Komisionerit risjell në vëmendje të kontrolluesit, dispozitat e udhëzimit nr. 9, datë 15.09.2010 “*Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në mediane dhe shkruar, vizive dhe audiovizive*” i ndryshuar, i cili synon të japë orientime shteruese për interpretimin e nocionit të interesit publik në kuadër të publikimit të të dhënave personale nga subjektet e tij.

Kësisoj, bazuar në Kreun IX të udhëzimit në fjalë, rrethanat që përcaktojnë interesin publik përfshijnë:

- a. interesin e sigurisë kombëtare;
- b. integritetin territorial ose sigurinë publike;
- c. parandalimin e trazirave apo krimit;
- d. parandalimet publike nga të qenit i mashtruar nga një veprim apo deklaratë e një individi;
- e. mbrojtjen e shëndetit ose moralit;
- f. mbrojtjen e reputacionit ose të drejtave të tjerëve;
- g. parandalimin e zbulimit të informacioneve konfidenciale, ose për të garantuar paanshmërinë e pushtetit gjyqësor, etj.

Rrethanat e mësipërme mund të jenë, rast pas rasti, të zbatueshme në mënyrë kumulative dhe/ose veçmas. Kjo mbetet në aftësinë e kontrolluesit përkatës për të mbështetur në argumente dhe fakte publikimin e informacioneve bazuar në interesin publik.

Në këtë kontekst, Zyra e Komisionerit në mungesë të reagimit dhe bashkëpunimit nga ana e Lapsi.al vijon ta ketë të pamundur të konstatojë se cilat rrethana të interesit publik ju shërben publikimi i të dhënave të 1800 punonjësve dhe oficerëve të policisë, midis të cilëve mund të ketë edhe persona të cilët mund të ushtrojnë, ose jenë në ushtrim e sipër, të misioneve me karakter infiltrues (parandalues dhe/ose zbulues).

Një analizë të tillë, në lidhje me implikimet e mundshme të personave të dhënat e të cilëve janë publikuar në faqen e internetit Lapsi.al⁴, nuk rezulton të jetë bërë as nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, e cila bart edhe peshën institucionale të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të personelit të saj.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit, rithekson sa ka artikuluar publikisht edhe në të shkuarën, në lidhje me këtë çështje, se interesi publik ndryshon nga interesi për publikun dhe nevoja për informacion nuk prevalon mbi nevojën për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të shtetasve.

Sa i përket PSSH, siç parashtrohet në pjesën përkatëse të këtij Relacioni dedikuar këtij kontrolluesi, Zyra e Komisionerit konstaton mangësi në nivel njohurish dhe masash tekniko-organizative për të garantuar një përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale, qoftë në kuadër të nevojave organizative të kontrolluesit në fjalë, qoftë në kuadër të fushatave elektorale.

PSSH, si dhe çdo organizim tjetër politik, nuk është e përjashtuar nga rregullat dhe detyrimet e parashikuara nga dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij.

Zyra e Komisionerit është tashmë në proces të rishikimit të Udhëzimit nr. 35, në mënyrë që të artikulojë edhe më qartësisht dhe konkretisht përgjegjësitë e subjekteve politike në drejtim të respektimit të privatësisë së shtetasve, si dhe garantimit të mbrojtjes së të dhënave të tyre personale.

Në cilësinë e kontrolluesit, PSSH, bart detyrimin për të garantuar që çdo strukturë e saj, në nivel qendror apo vendor, të respektojë detyrimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Asnjë formë aksioni organizativ nuk mund të tejkalojë kufijtë taksativë kushtetues, të cilët synojnë të garantojnë jetën private dhe mbrojtjen e të dhënave personale të shtetasve.

Për këtë arsye, krahas respektimit të parimeve dhe kriterëve të përpunimit të të dhënave personale, të sanksionuar në nenet 5 dhe 6 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është e domosdoshme që PSSH të marrë masa të cilat bëjnë të mundur evidentimin dhe gjurmimin e aksesit në bazën e të dhënave që ky subjekt ka në administrim, popullimi i së cilës bazohet në pëlqimin e shprehur të subjekteve të të dhënave (anëtarësisë së saj).

⁴ <https://lapsi.al/2021/04/14/emrat-1800-police-te-raportuar-nga-patronazhistet-e-rilindjes-votat-e-sigurta-mes-shefave/>.

PJESA 2 – Hetimi administrativ bazuar në ankesë

Pas nisjes së hetimit administrativ kryesisht, pranë kontrolluesve të treguar në Pjesën 1 të këtij Relacioni, me objekt verifikimin lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, nisur nga informacionet e publikuara në median elektronike, pranë Zyrës së Komisionerit kanë mbërritur ankesat si vijon:

- a. 2 ankesa për Lapsi.al;
- b. 4 ankesa për DPGJC;
- c. 31 ankesa për AKSHI;
- ç. 1 ankesë për DPT
- d. 40 ankesa për PSSH;
- dh. 1 ankesë për subjektin politik BD; si dhe
- e. 1 ankesë për një kandidat për deputet (DB).

Në lidhje me ankesat ndaj kontrolluesve të listuar në germat “a” deri “d” më sipër, meqenëse Zyra e Komisionerit kishte nisur tashmë një proces hetimor, ankesat në fjalë u trajtuan në kuadër të procesit hetimor kryesisht.

Vlen të theksohet se të dhënat personale të secilit prej subjekteve të të dhënave, që kanë paraqitur ankesë, rezultojnë të publikuara në Bazën e të Dhënave.

Gjithashtu, është konstatuar publikimi i këtyre të dhënave edhe nëpërmjet faqeve të internetit www.patronazhisti.com dhe <https://adfrehasdghf.web.app/>. Në lidhje me këto dy burime publikimi të paligjshëm të të dhënave personale, Zyra e Komisionerit ka kërkuar me iniciativën e saj bllokimin e tyre, si dhe fillimin e procedimit ligjor për publikuesit përkatës.

Për këtë qëllim, me shkresën nr. 693 prot., datë 16.04.2021, Zyra e Komisionerit i është drejtuar me shkresë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për marrjen e masave dhe hapave të sipërpërmendur, si fillim, për faqen e internetit www.patronazhisti.com dhe, më pas, me shkresën nr. 693/1 prot., datë 19.04.2021, për faqen e internetit <https://adfrehasdghf.web.app/>.

Pavarësisht ndërmarrjes së hapave ligjorë-proceduralë për zbulimin e burimit dhe krijuesit të Bazës së të Dhënave, Zyra e Komisionerit nuk ka gjetur të provuar asnjë nga ankesat drejtuar kontrolluesve përkatës, pasi referuar në Pjesën 1 të këtij Relacioni, ka rezultuar e pamundur të vërtetohet lidhja e kontrolluesve në fjalë dhe Bazës së të Dhënave.

Përrjashtim bën këtu Lapsi.al, pasi për këtë kontrollues Zyra e Komisionerit nuk ka mundur të realizojë asnjë hap konkret hetimor, qoftë në terren, qoftë nëpërmjet korrespondencës shkresore.

Në lidhje me kontrolluesin Bindja Demokratike (germa “dh” më sipër), Zyra e Komisionerit ka filluar një proces hetimi administrativ bazuar në urdhrin nr. 74, datë 28.05.2021, me objekt “*Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar*”.

Në konkluzion të këtij hetimi ka rezultuar se në kuadër të fushatës për zgjedhjet parlamentare që u zhvilluan në datë 25.04.2021, partia Bindja Demokratike ka publikuar në llogarinë e saj, në kanal youtube.com, spotin publicitar me titull “*Voto për një rini me mundësi të barabartë*”, në përmbajtje të të cilit ndodhet edhe imazhi-video i ankueses, i publikuar pa pëlqimin e saj.

Në përfundim të hetimit administrativ Zyra e Komisionerit, me Urdhrin nr. 91, datë 22.06.2021, ka urdhëruar fshirjen e imazhit të ankueses që shfaqej gjatë spotit publicitar.

Gjithashtu, në lidhje me kandidatin DB (germa “e” më sipër), Zyra e Komisionerit ka konstatuar se dërgimi i mesazheve për qëllim të fushatës elektorale pa pëlqimin e subjekteve të të dhënave është në kundërshtim me parashikimet e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Zyra e Komisionerit ka vepruar duke tërhequr vëmendjen kandidatit për deputet, duke i bërë me dije se përpunimi i të dhënave personale për qëllime të fushatës zgjedhore, legjitimohet vetëm nëse respektohen parimet e mbrojtjes së të dhënave dhe kriteret ligjore të përpunimit parashikuar në nenet 5 dhe 6 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 35.

Më tej, në kuadër të ankesave, në bazë të neneve 87 – 89 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, Zyra e Komisionerit ka thirrur në seancë dëgjimore kontrolluesit DPGJC, DPT, AKSHI dhe PSSH. Konkretisht, si vijon:

- (i) DPGJC është njoftuar, me shkresën nr. 703/4 prot., datë 28.07.2021, për pjesëmarrjen në seancën dëgjimore të datës 03.08.2021, ora 11.00.

Kontrolluesi u paraqit në seancë dhe, në lidhje me çështje e ngritura nga Zyra e Komisionerit, ka disponuar me shkrim, ndër të tjera, si vijon:

“Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka përgjegjësinë e kontrollorit mbi përpunimin e të dhënave personale të shtetasve dhe bashkëpërcaktues me AKSHI-n, për mënyrën e transmetimit të tyre ndaj institucioneve që mund t’i përfitojnë elektronikisht.”

Cështja e gjurmimit të të dhënave mbetet një ndër angazhimet dhe prioritetet e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, për të verifikuar dhe kontrolluar, informacionin e vënë në dispozicion ndaj organeve të tjera, të cilat legjitimohen në kërkimin e tij.

Në këtë kuadër, DPGJC duhet të gjurmojë sipas destinacionit përfundimtar të kalimit të të dhënave, qasjes monitoruese, për të cilat do të zhvillojmë veprimtarinë audituese të monitorimit, avancimeve të teknologjisë, për përhapjen e paligjshme të të dhënave me qëllim shmangien e çdo risku në përpunimin e tyre nga palët e legjitimuara në kërkimin e informacionit.

Në këtë drejtim do të vijohet me përcjelljen e komunikimeve shkresorë për qasjen monitoruese që do të zhvillohet ndërmjet autoriteteve më të larta në Ministrinë e Brendshme dhe Agjencinë Kombëtare të Informacionit (AKSHI)-n. Deri më tani për këtë çështje, DPGJC ka patur komunikim elektronik me AKSHI-n, në nivelin e drejtuesve të DPGJC-së.”.

Në konkluzion të hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit ka disponuar me rekomandim;

- (ii) DPT është njoftuar, me shkresën nr. 807/3 prot., datë 28.07.2021, për pjesëmarrjen në seancën dëgjimore të datës 03.08.2021, ora 11.30.

DPT nuk u paraqit në seancë dëgjimore ;

- (iii) AKSHI është njoftuar, me shkresën nr. 704/3 prot., datë 28.07.2021, për pjesëmarrjen në seancën dëgjimore të datës 03.08.2021, ora 12.00.

Kontrolluesi u paraqit në seancë dhe, në lidhje me çështjet e ngritura nga Zyra e Komisionerit sa i përket ankesave të paraqitura në drejtim të AKSHI, ka disponuar me shkresën nr. 5100/1 prot., datë 05.08.2021, ndër të tjera, si vijon:

“Në portalin qeveritar e-Albania nuk ruhen të dhëna të asnjë natyre. Çdo aplikim i bërë nga qytetarët dhe bizneset dërgohet për t’u ndjekur në institucionet që ofrojnë ato shërbime në regjistrat elektronikë përkatës, administratorë të të cilëve janë po ato.”

Në lidhje me numrin e subjekteve publike/private të cilëve AKSHI ju ka dhënë akses në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, kontrolluesi ka disponuar si vijon:

“[...] në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr. 10325/2021 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe VKM nr. 673/2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, si dhe të VKM nr. 945/2021 “Për miratimin e Rregullores “Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore””, AKSHI administron Platformën Qeveritare të Ndërveprimit dhe konsumimi i të dhënave në kohë reale nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit për të dhënat e

Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile është për 47 baza të dhënash shtetërore, të regjistruara pranë Autoritetit Rregullator Koordinues i Bazave të të Dhënave Shtetërore, pra pranë AKSHI.”

Në lidhje me sa më sipër, Zyra e Komisionerit rithekson sa konstatohet në faqet 26 - 34 të këtij Relacioni.

Në konkluzion të hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit ka disponuar me rekomandim;

- (iv) PSSH është njoftuar, me shkresën nr. 861/4 prot., datë 28.07.2021, për pjesëmarrjen në seancën dëgjimore të datës 03.08.2021, ora 12.30.

Kontrolluesi u paraqit në seancë dhe, në lidhje me çështjet e ngritura nga Zyra e Komisionerit sa i përket ankesave të paraqitura në drejtim të tij, ka disponuar nëpërmjet e-mailit datë 06.08.2021.

Nga përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga Zyra e Komisionerit, konstatohet se, nga të gjithë ankuesit, subjektet e të dhënave K.K. dhe Q.H. rezultojnë të jenë anëtarë të PSSH.

Sipas PSSH, subjektet në fjalë rezultojnë të kenë plotësuar formularin e anëtarit të partisë dhe të kenë dhënë të dhënat personale me vullnetin e tyre të lirë, në përputhje me rregullat e brendshme të organizatës në fjalë, si dhe dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Më tej, kontrolluesi ka disponuar si vijon:

“Sipas Kodit Zgjedhor neni 60 “Vënia e listave të zgjedhësve dhe ekstraktit të përbërësve zgjedhorë në dispozicion të subjekteve zgjedhore dhe publikut”, për zgjedhjet e përgjithëshme dhe vendore, në prag të fushatave elektorale subjekteve politike u vihen në dispozicion listat e zgjedhësve për çdo QV, për saktësimin e verifikimin e tyre në terren, sipas QV dhe bashkive dhe më pas këto lista nuk janë objekt ruajtje ose përpunimi nga ana jonë si subjekt politik”.

Në lidhje me këtë pohim, Zyra e Komisionerit rikonfirmon sa konstatohet në këtë Relacion sa i përket përbërësve elektorale, të cilat janë të dhëna që DPGJC vë në dispozicion të subjekteve zgjedhore në përputhje me nenin 60 të Kodit Zgjedhor⁵.

Nga ana tjetër, në lidhje me pohimin se “[...] këto lista nuk janë objekt ruajtje ose përpunimi nga ana jonë si subjekt politik”, Zyra e Komisionerit risjell në vëmendje të kontrolluesit PSSH sa konstatohet në faqen 39 të këtij Relacioni.

⁵ Shih, konstatimet në faqet 17 dhe 40 të këtij Relacioni.

Në cilësinë kontrolluesit, PSSH bart përgjegjësi për çdo veprimtari përpunimi të dhënash të kryer nga kjo organizatë në përmbushje të objektit dhe qëllimit të saj si person juridik.

Në konkluzion të hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit ka disponuar me rekomandim.

* * *